

**Shtëpitë
e pleqëve**
Banorët me
shumë halle

Fq.5




**STRATEGJIA
E RE**
Të rinjtë
megjithatë
po ikin jashtë

Fq.4



Me patent
shoferë të
Maqedonisë
Në
Gjermani

Fq.5



Koha

www.koha.mk



KOHA
për sport

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3374 · E hënë, 28 maj 2018

13°C | 28°C

15 DEN

EDITORIAL

**“Monstrat”
me diplomë!**



Të gjithë treguesit flasin se nëpër universitete po regjistrohen studentë që kanë probleme elementare të mosdijes dhe kjo gjendje i përshkruhet dobësive të shumta që aktualisht ka shkollimi fillor e i mesëm. Nëse tolerohet kjo gjendje edhe në të ardhmen, atëherë janë shumë të mëdha gjasat që shoqëria të paguaj kosto të lartë shumëzimin e “monstrave” me diplomë, të cilët objektiv final kanë punësimin, por jo përvetësimin e dijeve për të ushtruar denjësisht profesionin.

Fq.2

RAJON

**Pasoja e
“Zajednicës”
në rrugën
Deçan-Plavë**

Fq.16

SPECIALE

**Shkupi
dhe shkollimi
shqip**

Fq.18-19



AVOKATI I POPULLIT DETEKTON PROBLEME NË KADASTËR

DENACIONALIZIMI PENGOHET ME VITE



Një problematikë e pazgjidhur ndër vite e cila drejtpërdrejtë i prek qytetarët është zvarritja e procesit të denacionalizimit. Kësisoj zyra e Avokatit të Popullit në raportin e punës për vitin 2017, ka theksuar se qytetarët deri në pafundësi ballafaqohen me zvarritjen e procedurave për kthimin e pronës së tyre

Fq.3

Nisin punimet në kufirin Bellanoc-Stançiq

Vendkalimi i shumëpritur Bellanoc-Stançiq, që në Malësinë e Karadaku lidh Republikën e Maqedonisë me atë të Kosovës, më në fund po bëhet realitet. Kjo nga fakti se tashmë kanë filluar edhe punimet për ndërtimin e objektit të përbashkët të këtij vendkalimi kufitar. “Këtu do të ndërtohet një objekt i sistemit të integruar evropian ku mjetet janë të siguruar nga UE nga IPA Fondet, bartësit e këtij procesi janë qeveria e RM dhe qeveria e RK. Eeveria jonë e Republikës

së Maqedonisë e ka autorizuar qeverinë e Republikës së Kosovës që ti kryej gjitha procedurat administrative ku të njejtat janë kryer është zgjedhur kontraktuesi dhe se punimet kanë filluar në fazën përgatitore, ndërkaq brenda javës së ardhëshme do filloj edhe faza tjetër pra faza e ndërtimit, që besoj se ky është një projekt kapital për të dyja anët e këtyre vendbanimeve”, deklaroi për MTV në gjuhën shqipe, kryetari i Komunës së Likovës, Erkan Arifi.

Fq.4



Një problematikë e pazgjidhur ndër vite e cila drejtpërdrejtë i prek qytetarët është zvarritja e procesit të denacionalizimit. Kësisoj zyra e Avokatit të Popullit në raportin e punës për vitin 2017, ka theksuar se qytetarët deri në pafundësi ballafaqohen me zvarritjen e procedurave për kthimin e pronës së tyre

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 27 maj- Vendimet gjyqësor dhe udhëzimet e Avokatit të Popullit, për shqyrtimin e lëndëve kontestuese nuk vlejnë për Agjensinë e Kadastrës. Veprimet subjektive dhe jo profesionale të nëpunësve të kadastrës, siç thekson Ombudsmanin në raportin vjetor të tij, kanë shkaktuar pasojë të dëmshme në raport me realizimin e të drejtave legjitime të qytetarëve. Mos përfillja e vendimeve të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative, më së mirë e shpjegon fakti se administrata e kadastrës, një lëndë të caktuar, disa herë e ka arsyetuar me përmbytjen e njëjtë.

"Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në bazë të intervenimeve tona, respektivisht kërkesave për iniciimin e veprimeve për kontroll të ligshmërisë, për një lëndë të caktuar. Konkretisht, nga Sektori për kontroll dhe mbikëqyrje të Agjencionit për Kadastrë deri te njësitë organizative në Shkup dhe më gjerë, është parashtruar urdhëresë e detyrueshëm për veprim. Megjithatë, pas përjashtim sektorët përkatës japin vërtetim për refuzim të kërkesës konkretë të palës. Shkelja e afateve ligjore, zvarritja e lëndëve dhe mos procedimi në kohë po ashtu janë pjesë përbërëse e punës së zyrës së kadastrës", thotë

AVOKATI I POPULLIT DETEKTON PROBLEME NË KADASTËR

DENACIONALIZIMI PENGOHET ME VITE



Ombudsmani në raportin e punës për vitin e kaluar. Zyra e Avokatit të Popullit njëkohësisht ka konstatuar se mos pranimit i arsytimit, informacioneve dhe dëshmitave për lëndët e çështjeve juridiko-pronësore ka vazhduar nga Qendra e kadastrës në Shkup edhe gjatë vitit 2018. Me këtë mënyrë të veprimeve ky sektor i kadastrës drejtpërdrejtë e ka penguar Ombudsmanin në shqyrtimin dhe realizimin e detyrave të tij.

Një problematikë e pazgjidhur ndër vite e cila drejtpërdrejtë i prek qytetarët është zvarritja e procesit të denacionalizimit. Kësisoj zyra e Avokatit të Popullit në raportin e punës për vitin 2017, ka theksuar se qytetarët deri në pafundësi ballafaqohen me zvarritjen e procedurave për kthimin e pronës së tyre. Pengimi i realizimit të të drejtës kushtetuese, siç është në këtë rast procesi i denacionalizimit, sipas

ombudsmanit, zvarritet për shkak se organet administrative (Ministria e Financave, komisionet për denacionalizim dhe Komisioni shtetëror për shqyrtim të ankesave nga shkalja e dytë) nga njëra anë dhe gjykatat administrative në vend fare pakë komunikojnë, për mos të thënë aspak.

"Krahas fakti se me dekada të tëra nga ana e tyre ekziston jo efikasitet dhe mungesë e kualitetit në vendimmarrjen dhe shpërfillje të rrethanave se esenca e punës së tyre është sigurimi i interesave të qytetarëve, në institucionet e aposto-fuar ekziston edhe një sistem tejet i keq i procedurave për dorëzimin e shkresave dhe miratimi të vendimeve për lëndë. Ndërkohë, gjykatat administrative, përveç se përfshinë në këtë kategori të administratës jo efikase, ato nuk i shfrytëzojnë kompetencat ligjore për mbajtjen e debateve një çështje të caktuar admi-

nistrative", thuhet në raportin e Ombudsmanit.

E gjithë kjo amulli e cila mbizotëron në organet e larta shtetërore, siç thuhet në raport nuk është vetëm për shkak të mungesës së financave apo kuadrove, por edhe për arsye të mungesës së mekanizmave kompetente për organizim të brendshëm dhe kontroll të punës. Pikërisht për shkak, koha me e madhe harxhohet në dorëzim-pranimin e shkresave (lëndëve), se sa në procedimin e rasteve.

Të dhënat e zyrës së Ombudsmanit, flasin se në gjykata ekzistojnë raste kur lëndë është miratuar dhe për të njëjtën ekziston vendim i prerë, mirëpo vite me radhë e njëjtat nuk i është dorëzuar komisioneve përkatëse për denacionalizim, respektivisht as këtë të fundit fare nuk kanë shprehur interes për ecurinë e një lëndë të caktuar.



Lajm i mirë për asistentët dhe demonstratorët

Vërejtja e profesorëve universitar është se në ndryshimet e reja ligjore të Ligjit për arsim të lartë, i cili tashmë është në fuqi, nuk ka nen me të cilin do të rregullohej punësimi i ri kur një profesor shkon në pension, edhe pse në këtë gjë kanë insistuar.

Ata kanë kërkuar që institucioni i arsimit të lartë të mundet që me ato para që i ka pranuar profesori të angazhojë kuadër të ri dhe të shpallë konkurs pa pasur obligim që të kërkojë pajtim për punësim nga Ministria e Arsimit.

Ministri i Arsimit, Arbër Ademi tha se me ndryshimet e Ligjit, fakulteteve dhe universiteteve i jepet mundësia që të angazhojnë asistent dhe demonstrator, e drejtë e cila me vite i ka munguar. Për punësimin e profesorëve edhe më andej do të duhet që të dërgojnë kërkesë për miratim te ministria e arsimit.

"Në lidhje me politikën e kuadrove në Ligjin për arsim të lartë ka rregulla mjaft cilësore dhe më shumë të drejta për institucionet e arsimit të lartë, që të zhvillojnë një politikë të tillë kuadrove e cila do të korrespondojë me nevojat e tyre. Ne i kemi kthyer edhe demonstratorët edhe asistentët që është shumë me rëndësi, për secilin lloj të angazhimit nuk duhet pajtim nga institucionet kompetente. Për shembull, për angazhimin e demonstratorëve në institucionet e arsimit të lartë nuk duhet pajtim nga ministria e financave. Vet fakultetet dhe universitetet mund që të angazhojnë kuadër nga radhët e të rinjve që kanë sukses të shkëlqyeshëm e që i plotësojnë kushtet dhe duan që të ndërtojnë karrierë. Universitetet publike janë të ekuipuar mirë, kanë kuadër të mjaftueshëm, edhe pse gjithmonë ekziston nevoja për angazhimin e kuadrove të rinj", deklaroi Ademi

Kumanovë, shpërthen bombë, nuk ka të lënduar



Në Stacionin Policor në Kumanovë, të shtunën në mbrëmje është raportuar për një incident. 26 vjeçari M.C. nga ky qytet ka lajmëruar se derisa ka qenë duke fjetur ka dëgjuar një eksplozim nga ballkoni i katit të parë nga shtëpia familjare. Nga eksplozimi janë shkaktuar dëme në shtëpi- është thyer xhami i dritares,

roleta dhe muri. Fatmirësisht nuk ka persona të lënduar.

Kontroll në vendngjarje ka kryer ekipi i SPB-së në Kumanovë. Nga vendi i ngjarjes janë ngritur fragmente nga bomba e dorës për ekspertizë.

Policia ndërmerr masat e nevojshme për zbardhjen e tërësisht të rastit.

XHAFFERI NË MËNGJESIN E LUTJES NË TIRANË

Takimet e mëngjesit të lutjeve janë një traditë inspiruese që përçojnë vlerat e besimit, paqes dhe dashurisë, dhe pikërisht janë këto vlera thelbësore që i nevojiten njerëzimit për tu ballafaquar me sukses me sfidat globale të shekullit të 21-të, porositi kryetari i Kuvendit, Talat Xhferi në Takimin e 15-të Evropës Juglindore, që po mbahet në Tiranë.

Është fakt, shtoi se çdo ditë e më shumë është duke u krijuar një kontekst global i ekzistencës së njeriut, qoftë në kontekstin ekonomik, politik, kulturor, apo religjioz.

"Prandaj, vlerësoj se Mëngjesi i Lutjes është një mundësi për t'i shkëmbyer përvojat, qëndrimet apo bindjet tona në lidhje me ndodhitë globale aktuale dhe sfidat që sjellin ato, si dhe njëkohësi-

sht të shprehim falënderimet tona për mirëqenien, miqësinë dhe bashkëpunimin reciprok. Më vjen mirë që Mëngjesi i Lutjeve këtë vit prek çështjen e dashurisë dhe respektit ndaj fqinjët, pasi që Republika e Maqedonisë me formimin e Qeverisë së re është e orientuar pikërisht ndaj ndërtimit të mirëkuptimit dhe marrëdhënieve të mira me fqinjët", tha Xhferi.



Mbi 56 për qind e të anketuarve nga ana e Unionit të Studentëve Shqiptarë mendojnë se alternativa e vetme për punësim, pasi ti kryejnë studimet, është të largohen nga Maqedonia, kurse 22 për qind e mendojnë këtë alternativë "ndonjëherë".

Koha

Laura PAPERANIKU

Shkup, 27 maj – Kush më shumë e kush më pak, të rinjtë e shkolluar nga Maqedonia e shohin perspektivën e jetës jashtë vendit. Që në auditorët e studimeve mendojnë të kryejnë sa më shpejt fakultetin dhe të gjejnë një mënyrë se si të punësohen në shtetet e Bashkimit Evropian, ndërkaq të dhëna zyrtare për papunësinë e të rinjve nga moshën 15 deri 24 vjet janë alarmante. Në Strategjinë e Nacionale të të Rinjve (2016-2025) të përgatitur nga ana e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH) theksohet se një prej problemeve kryesore me të cilin ballafaqohen të rinjtë në Maqedoni është shkalla e lartë e papunësisë. "Në vitin 2015, tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, shkalla e papunësisë arriti 48.2 për qind e popullatës së kësaj moshë", thuhet në këtë Strategji, ndërsa sqarohet se ky problem ka një lidhje të ngushtë me gjendjen financiare dhe ka ndikim mbi një sërë çështjesh të tjera që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës. Shqetësues sipas të dhënave të strategjisë përkatëse është edhe përqindja e të rinjve që nuk janë përfshirë as në procesin e arsimit, nuk janë as në punë dhe as në ndonjë program trajnimit. Kjo shkallë, thuhet se ka arritur në rreth 30 për qind të popullatës përkatëse.

ARSIMI ME STRATEGJI TË RE



TË RINJTË MEGJITHATË PO IKIN JASHTË

Aktualisht të gjitha matjet e perceptimit publik, flasin se shumë pak të rinj mendojnë të mbesin në Maqedoni pasi të kryejnë studimet. Në një sondazh që realizoi Unioni i Studentëve Shqiptarë (USSH) vetëm 21.6 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk e mendojnë largimin si alternativë të vetmen. Pyetjes "A e mendoni si alternativë të vetme dhënien e kontributit tuaj jashtë vendit", i janë përgjigjur me "po" 56.1 për qind e të anketuarve, ndërsa

22.3 përqindëshi i mbetur kanë rrethuar si të saktë opsionin "ndonjëherë". Është interesante se vetëm pak më tepër se gjysma e studentëve, respektivisht 56.1 për qind e të anketuarve kanë thënë se "shpresoj në gjetjen e një pune të përshtatshme pas mbarimit të studimeve". Të tjerët, 16.9 për qind se "nuk shpresojnë" kurse 27 për qind se kjo "varet nga aftësitë". Te mungesa e perspektivës në Maqedoni venë theksin pjesa dërmuese e studentëve në përgjithësi. Një anketë tjetër të cilën kanë realizuar studentët e Fakultetit të Shkencave Informatike

dhe Inxhinierisë Kompjuterike, rreth 83 për qind janë shprehur se do të largoheshin për të studiuar jashtë vendit nëse do të kishin një mundësi të tillë. Në pyetjen se "cila është arsyeja kryesore e largimit të një numri të madh të studentëve nga Maqedonia, jashtë vendit" 65.2 për qind e studentëve përgjigjen "mungesa e perspektivës", 15 për qind "standardi i dobët", 12 për qind "gjendja politike" dhe 5 për qind "sistemi arsimor".

Ky trend shqetësues është konstatuar edhe me studimin e fundit të Fondacionit "Fridrih Ebert", i cili trajtuar gjithashtu shpesh herë çështjen e shpërnguljeve dhe migracionit.

"Gjysma e të rinjve në Maqedoni duan të largohen jashtë vendit, ndërsa një e treta prej tyre as që mendon të kthehet përsëri në Maqedoni. Mungesa e perspektivës, pasiguria politike dhe partizimi i madh janë faktorët kryesor që demotivojnë të rinjtë të planifikojnë të ardhmen e tyre në Maqedoni. Plotë 67 për qind e të

anketuarve ankohen për problemet financiare dhe nuk besojnë se pas mbarimit të studimeve do të gjejnë punë", qëndron mes tjerash në dokumentin e studimit në fjalë. Kjo, thuhet më tej, ka ndikim negativ mbi tregun dhe fuqinë punëtore. Në rekomandimet e dokumentit Strategjia Nacionale e të Rinjve, MASH e konsideron si emergjente marrjen e masave për të penguar largimin e të rinjve, sidomos atyre që kryejnë studimet fushave teknike. "Duket vërtetë shqetësues fakti që rreth 80 për qind e studentëve të viteve të fundit, që studiojnë në fakultetet teknike (që vlerësohen si fakultete më atraktive për t'u larguar jashtë vendit pas mbarimit të studimeve) mendojnë ose planifikojnë të largohen nga Maqedonia. Nëse nuk do të zhvillohen aktivitete gjithëpërfshirëse, kjo shifër do të rezultojë me një ulje serioze të potencialit të zhvillimit ekonomik dhe demografik dhe në një afat më të gjatë do të ketë implikime serioze negative për Maqedoninë", qëndron në atë dokument.

SHKOLLAT E MESME STOLISEN ME DYSHA E TRESHA!

Shkup, 27 prill - Lista me rangimin e shkollave të mesme, në nivel republikan në fund të vitit të kaluar shkollor, tregon se nxënësve të shkollave të mesme nuk u mësohet për dallim nga ata të filloreve. Më rëndë arrihet në notën 5 tek shkollat e mesme sesa në fillore, njofton KOHA. Ky përfundim mund të arrihet nëse shihet lista me notat mesatare të të gjitha shkollave fillore të Maqedonisë. Vetëm një shkollë ka mesatare mbi 4, ndërsa shumë shkolla mezi arrijnë në notë mesatare 3. Nga qindra shkolla të mesme rreth 40 shkolla kanë mesatare më pak se 3. Për dallim nga shkollat e mesme, lista me shkollat fillore të Shkupit tregon se mesatarja e tyre është më e lartë.

Nota më të mira në nivel republikan kanë nxënësit e shkollës së mesme të Shkupit, Gjimnazit "Orce Nikollov". Vitin e kaluar notë mesatare e kësaj shkolle ka qenë 4.18. Në nivel komunal ku ka më shumë se 5 shkolla të mesme mesatare më të mirë kanë shkollat në Manastir edhe atë 3.36, në Shkup me sukses 3.23, Kumanovë 3.19, Prilep 3.07. Komuna e Tetovës ka rezultate më të dobëta me mesatare 2.66.

Nga shkollat me mësim në gjuhën shqipe, Gjimnazi i Sarajit ka arritur mesatare vetëm 2.86, Gjimnazi "Zef Lush Marku" 2.88, "Cvetan Dimov" 2.59, "Dr Pance Karagjovov" 3.58, "Arseni Jovkov" 2.78, "Marija Kiri Sklodovska" 2.96. (A.XH)



Në më shumë qytete në Greqi janë paralajmëruar protesta për më 6 qershor, kundër bisedimeve për çështjen e emrit. Organizatorët

Grekët kundër emrit të ri të Maqedonisë

e protestave janë të njëjtët që organizuan protesta në Selanik dhe Athinë, por kësaj radhe nuk do të protestohen në këto dy qytete por në disa tjera, të cilat ende nuk janë bërë të ditura, shkruan Nezavisen.

Organizatorët e protestave thonë se duan të rikujtojnë qeverinë që populli grek është kundër çdo lëshimi për emrin e Maqedonisë, dhe kërkojnë që të respektohet dëshira e po-

pullit. Siç njoftuan sot, tani më janë në kontakt me qeverisjen lokale të vendeve ku do të mbahen protesta dhe është kërkuar mbështetje nga ana e tyre.

Ndërkaq, mijëra grekë në janë protestuar në Selanik dhe në shkurt në Athinë me mesazhin "Maqedonia është greke" duke kundërshtuar kështu negociatat për gjetjen e kompromisit për çështjen e emrit.

Nisin punimet në kufirin Bellanoc-Stançiq

Vendkalimi i shumëpritur Bellanoc-Stançiq, që në Malësinë e Karadakut lidh Republikën e Maqedonisë me atë të Kosovës, më në fund po bëhet realitet. Kjo nga fakti se tashmë kanë filluar edhe punimet për ndërtimin e objektit të përbashkët të këtij vendkalimi kufitar.

"Këtu do të ndërtohet një objekt i sistemit të integruar evropian ku mjetet janë të siguruar nga UE nga IPA Fondet, bartësit e këtij procesi janë qeveria e RM dhe

qeveria e RK. Eeveria jonë e Republikës së Maqedonisë e ka autorizuar qeverinë e Republikës së Kosovës që ti kryej gjitha procedurat administrative ku të njëjtat janë kryer është zgjedhur kontraktuesi dhe se punimet kanë filluar në fazën përgatitore, ndërkaq brenda javës së ardhëshme do filloj edhe faza tjetër pra faza e ndërtimit, që besoj se ky është një projekt kapital për të dyja anët e këtyre vendbanimeve", deklaroi për MTV në gjuhën shqipe, kryetari i

Komunës së Likovës, Erkan Arifi.

Përpos qarkullimit të lirë të qytetarëve nga të dyja anët e kufirit, hapja e këtij vendkalimi kufitar mundëson edhe zhvillimin e bizneseve të ndryshme por edhe ekonomisë në përgjithësi.

"Ky projekt është i shumëpritur për banorët e komunës tone dhe banorët që jetojnë andej pikes kufitare të Republikës së Kosovës, për arsye se kjo pike kufitare ka një tretman më të gjerë duke parashikuar qarkullimin e lire të njerëz-



ve, zhvillimin ekonomik-lokal, bizneset e vogla dhe të mesme kështu që në këtë pike kufitare do kemi një zhvillim, një e padrejtë që u është bërë këtyre vendbanimeve", thot Erkan Arifi.

Ky projekt do të kushtojë mbi

1.300.000 Euro fonde këto të siguruar nga IPA Fondet. Në bazë të dinamikës së paraparë të punimeve pritët që ky vendkalim kufitar deri kah tetori i këtij viti të jetë funksional për lëvizjen e lirë të qytetarëve.

BANORËT ME SHUMË HALLE TË SHTËPIVE TË PLEQËVE

Vitet e pleqërisë nuk po kërrusen gjithaq nga mosha sa nga vetmia dhe kostoja e papërbalueshme në shtëpive ku ata mundohen të zëvendësojnë ngrohtësinë e familjes dhe mungesën e fëmijëve, që janë tretur si shpend të trembur shtegtar diku larg vendlindjes

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 27 maj – Në Maqedoni janë 18 shtëpi që përkujdesen për pleqtë, prej tyre 15 janë në Shkup, ndërsa të tjerat janë në Manastir, në Prilep, në Kumanovë dhe në Negotinë. Qytetet tjera kanë mungesë të theksuar të shtëpive të pleqëve, dhe kjo vie në shprehje sidomos kur është i pamjaftueshëm ose fare hiq kujdesi familjar. Në mesin e këtyre qyteteve bën pjesë edhe Struga, por edhe Dibra, të cilët kanë nevojë për shtëpi pleqësh.

Në të shumtën e rasteve është mungesa e pranisë së fëmijëve, të cilët janë larguar jashtë vendi, një ndër arsytet që e imponojnë domosdoshmërisht të shtëpive të pleqëve.

Mirëpo është edhe problemi i koston që nuk arrin të mbulohet me pensionet që marrin pleqtë. Çmimi që kanë vënë shtëpitë e pleqve në vend është prej 11.800 - 2500 denarë. Ndërkohë që vlera mesatare e pensionit sillet rreth 12.000 denarë.

Mjekja Monika Mikrovskaja flet për kushtet e shtëpisë që ajo udhëheq.

"Kemi pleq të gjinisë mashkullore dhe janë diku 80 persona. Çmimi lëviz prej 60 euro ose 3.700 denarë, në muaj. Kemi motra medicinale, ofrojmë terapi. Moshat



e treta vetë vijnë, por varësisht nga gjendja e pacientit edhe i detyrojnë", thotë për gazetën "Koha", dr. Monika Mikrovskaja, nga shtëpia e pleqve "Mirkovski" në Shkup.

Në shtëpinë e pleqëve "Elisaveta" u ofrohet ndihmë pleqve me probleme fizike por edhe psikike.

"Kemi 45 persona dhe gjithçka është e plotësuar dhe kushton 3400 denarë. Janë pleqë me probleme psikike dhe fizike", tha Ivana Shutinovska nga mbrotja sociale e shtëpisë së pleqve "Elisaveta", në Shkup.

Në Gazi Babë, të Shkupit, mbizotërojnë më shumë gra në shtëpinë e pleqve, të cilëve u ofrohet ndihmë.

"Çmimi i këtushëm është 2500

denarë për një muaj. Ofrojmë mbikëqyrje 24 orë dhe kemi tre përgjegjëse nga motrat medicinale, të cilat kujdesen për ushqim dhe për shërbime të tjera. Kjo kategori e njerëzve e drejtuar tek ne bëhet më shumë nga fëmijët e tyre, arsytet i dinë vetë ata dhe ne kemi më shumë gra", tha Marina Mustakovska nga shtëpia e pleqëve "Ruski", në Gazi Babë.

Xhemaledin Nexhipi, drejtor i shtëpisë së pleqve në Kumanovë thotë se edhe pse kostoja është e lartë në qendrën e tyre, të mosshuarit megjithatë kanë interesim. Ai shton se kapaciteti në këtë shtëpi arrin mbi 100 persona, kurse pagesa bëhet ose nga buxheti privat i pleqve ose nga Qendra sociale.

"Ka pleq të interesuar dhe ne kemi kapacitet diku 160 persona. Numri i personave të pranishëm të moshës së tretë ndryshon varësisht nga kërkesa dhe tek ne janë më shumë gra. Kushtet janë relativisht të mira dhe kompensimi mujor arrin deri në 11.800 denarë. Ka pleq që vijnë vullnetarisht, disa me detyrim nga familjarët të cilët nuk i kanë kushtet e mira. Nga këto që i kemi, 30 persona janë nga qendra sociale të vendosur, te ne. Pra, personat përmes kësaj qendre sociale nuk paguajnë, por për këta ndihmon shteti, sepse nuk kanë pension dhe nuk kanë kushte ose nuk kanë bashkëfamiljar se kush të kujdeset, pra ne i pranojmë kërkesat e tyre dhe i vendosim në qendrën tonë. Ata që paguajnë privatisht, janë 120 persona. Në kemi kontratë bashkëpunimi me Spitalin e përgjithshëm, ku një herë në javë vjen një mjek dhe psikiatri. Kështu që kemi përkujdesje mjekësore", thotë për gazetën "Koha", Xhemaledin Nexhipi, drejtor i shtëpisë së pleqve. Sipas tij çmimi që është përcaktuar nga kjo qendër kundrejt pensioneve, është e lartë, prandaj dhe shumë të tjerë që kanë nevojë për shërbime, hezitojnë të sistemohen në këtë qendër.



Miratohet strategjinë fiskale 2019-2021

Shkup, 27 maj – Ministria e Financave ditë më parë miratoi strategjinë fiskale 2019-2021, sipas së cilës borxhi publik deri në vitin 2021 parashihet të rritet për 7 për qind, krahasuar me vitin 2017. Borxhi publik në vitin 2016 ishte 47,6 për qind nga Bruto Prodhimi Vendor (BPV) apo 4,8 miliard euro dhe sipas projekteve të Ministrisë së Financave deri në fund të vitit 2021 borxhi publik do të rritet për 600 milion euro. Nga Ministria e Financave informojnë se për momentin niveli i borxhit publik është i qëndrueshëm mirëpo në strategjinë fiskale për vitin 2019-2021 aspak nuk parashihet se si do të sigurohen 600 milion euro plotësuere deri në fund të vitit 2021 dhe si alternativë mbetet dhënia e euro bondit të ri. "Paratë do të shfrytëzohen për financimin e deficitit buxhetor afatmësëm, për pagesën e një pjese të borxheve të vjetra, një pjesë do të shkojë për investime në infrastrukturën rrugore dhe për ndërtimin e disa projekteve kapitale", thonë nga Ministria e Financave. Sipas strategjisë 3 vjeçare, në vitin 2020 dhe 2021 Maqedonia do të duhet të kthejë borxhin për euroobligacionet e emetuara në vitin 2014 dhe 2015 në vlerë të përgjithshme prej 678 milion euro si dhe këstin e dytë të huasë marrë nga Banka Botërore në vlerë prej 155 milion euro. Në strategjinë fiskale 3 vjeçare parashihet që vitin e ardhshëm të kemi dhe rritje të buxhetit. Për këtë viti buxheti i përgjithshëm është 3,5 miliard euro ndërsa buxheti i viti 2021 parashihet të kalon vlerën mbi 4 miliard euro. E gjithë kjo sipas Ministrisë së Financave është e mundshme vetëm nëse buxheti do të mbushet nga rritja ekonomike që parashihet të jetë në nivelin prej 5 për qind nga BPV-ja, dhe deficitit buxhetor të mos jetë më i lartë se 2 për qind. (Z.V.)

Në Gjermani me patent shoferë të Maqedonisë

Shkup, 27 maj – Procedura për nënshkrimin e marrëveshjes për njohjen e patent shoferit të shtetasve të Maqedonisë që jetojnë dhe punojnë në Gjermani është në fazën përfundimtare dhe se marrëveshja tani më është harmonizuar nga të dyja palët dhe se nuk ekzistojnë pengesë formale për nënshkrimin e marrëveshjes.

Për momentin pritet të caktohet data

se kur do të nënshkruhet marrëveshja, ka deklaruar ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski pas takimit që pati me këshillin iniciues për njohjen e patentë shoferit nga Gjermania. Në këtë takim përfaqësuesit e këshillit iniciues e njoftuan ministrin Spasovski se deri tani janë grumbulluar 42 mijë nënshkrimet dhe se është e rëndësishme që kjo

çështje të rregullohet midis ministrisë së Punëve të Brendshme të Gjermanisë dhe Maqedonisë sidomos për faktin se në Gjermani jetojnë një numër i madh i shtetasve të Maqedonisë dhe se njohja reciproke e patent shoferit do ta lehtësonte qarkullimin e lirë në komunikacion në Gjermani të shtetasve të Maqedonisë.

(Z.V.)





Prodhimtaria organike e ushqimit në Maqedoni mund të jetë e suksesshme, por vetëm me kushte që të orientohet në eksport. Përvojat e disa prej eksportuesve tregojnë se tregjet evropiane dhe botërore kërkojnë prodhime organike dhe të shëndosha që mund të prodhohen tek ne.

TOKË SHTETËRORE PËR PRODHIMTARI ORGANIKE

Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 27 maj- Prodhimtaria organike e ushqimit në Maqedoni mund të jetë e suksesshme, por vetëm me kusht që të orientohet në eksport. Përvojat e disa prej eksportuesve tregojnë se tregjet evropiane dhe botërore kërkojnë prodhime organike dhe të shëndosha që mund të prodhohen tek ne. Aktualisht vetëm 0.5 për qind e tokave bujqësore në Maqedoni janë të mbjella me prodhimtari organike. Kjo paraqet një sasi shumë të vogël në raport me mundësitë dhe kërkesat e tregut sidomos atij të huaj për një ushqim të shëndoshe organik. Sipas të dhënave të Odës Ekonomike të Maqedonisë, në shtet janë të regjistruar vetëm 533 fermerë të prodhimtarisë organike që më së shumti kultivojnë kultura të perimeve dhe të drithërave në një tokë prej afër 3200 hektarë.

Në ndërkohë, agronomët thonë se një nga alternativat e zgjidhjes së problemit të përvit-

shëm të plasmanit të prodhimeve bujqësore, në treg është tek prodhimtaria organike që se vjen e më shumë do të kërkohet në treg për çka Maqedonia ka kushte ideale. Prodhuesit organik thonë prodhimet e tilla kanë një treg të garantuar, por me kusht që fermerët të respektojnë rregullat rigorozë të kultivimit dhe të kenë durim që pas disa vitesh të presin fitimin.

“Nuk paraqet ndonjë problem të madh të eksportohen prodhimet organike nga Maqedonia jashtë shteti në rast se keni një prodhimtari të standardizuar, i posedoni certifikatat e nevojshme, kushtet e magazinimit etj. Megjithatë duhet shtuar se prodhimtaria organike kërkon edhe më shumë investime që edhe kthehen me kalimin e kohës. Rekomandohet që së paku 80 për qind e totalit të prodhimtarisë të jetë e orientuar në eksport për të pasur sukses në treg”, thotë Suzana Dimitrievska nga kooperativa “Lipa”, prodhues e ushqimit organik që nga viti 2005, që eksporton gro-

shën e saj organike në Zvicër.

Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë është fuqishme angazhuar të krijojë kushte të volitshme për prodhimtarinë organike në vend, duke marrë parasysh kërkesën e madhe të tyre në tregjet e jashtme. Andaj edhe Ministria e Bujqësisë me më shumë masa përkrah prodhimtarinë organike në vend.

“Në fund të këtij muaji apo në fillim të muajit të ardhshëm do të publikohet shpallja e vlefshme 1.2 milion euro për fermerët e rinj, ku përparësi do të kenë prodhuesit e organik të ushqimit që do të fitojnë grante prej 10 mijë euro. Gjithashtu, për herë të parë do të shpallet thirrje publike për ndarjen e tokës shtetërore të dedikuar vetëm për prodhimtarinë organike”, theksoi ministri i bujqësisë Ljupço Nikollovski, duke prezantuar një pjesë të masave të dedikuara vetëm për prodhuesit organik. Masat u prezantuan në tryezën e rrumbullakët kushtuar nxitjes së prodhimtarisë organike të ushqimit në Maqedoni.

Sipas tij, një vëmendje e veçantë do ti kushtohet edhe prezantimit të prodhimit organik vendor në shtetet e jashtme, ku në panairin sloven në Cornja Radgona që mbahet në fundin e muajit gusht, Maqedonia do të ketë stendën më të madhe dhe do të jetë partnere e panairit.

Njëherazi do të përgatitet edhe karta e rajoneve organike, ndërsa në përgatitje e sipër është edhe regjistri i prodhuesve organik që do të përmbajë të dhënat për të gjithë prodhuesit organik në Maqedoni, lidhur me certifikimin, llojin e kulturave bujqësore, lokalitetet e prodhimtarisë si dhe sasinë që prodhohen. Ndryshe, në vitet e fundit tregu i prodhimeve organike është rritur në mbi 90 miliardë euro që kryesisht furnizohet nga Evropa Lindore dhe juglindore. Kjo duhet të paraqesë një stimulim edhe për prodhuesit vendor të orientohen në prodhimtarinë organike, për shkak se kanë plasman të sigurt të prodhimeve të tyre.

FRI dekoroi semimaturantët më të mirë të Pollogut

Tetovë, 27 maj-Forumi Rinor Islam – Dega Tetovë në bashkëpunim me organizatën humanitare “Kalliri i mirësisë”, edhe këtë vit ka shtruar iftarin tradicional të përbashket me përfaqësues të institucioneve shtetërore, institucioneve kryetar organizatash, gazetarë dhe personalitete tjera si dhe anëtarë dhe aktivistë të Forumit Rinor Islam. Këtë vit bashkë me iftarin është organizuar edhe manifestimi i dekorimit të semimaturantëve më të mirë të Tetovës dhe rrethinës me moton “Të nxisim dijen, të investojmë për ardhmërinë, manifestim tanimë tradicional ky i cili ka për qëllim të dëshmojë se Islami e don dhe e çmon diturinë. Përndryshe ky manifestim që organizohet nga Forumi

Rinor Islam Dega Tetovë është i katërmbëdhjeti me rradhë dhe do të vazhdohet me organizimin e këtij manifestimi për të stimuluar nxënësit për të mësuar fituar sa më shumë dituri pasiqë dituria është fundamenti i fuqisë lëvizëse në shoqërinë njerëzore dhe parakushti themelor për suksese nënvizuan nga Forumi Rinor Islam Dega Tetovë.

Myftinia dhe Komuna e Tetovës organizuan Ditën e Poezisë

Tetovë, 27 maj-Në vazhdën e aktiviteteve të përbashkëta Myftinia dhe Komuna e Tetovës në ambientet e Fakultetit të Arteve pranë Universitetit të Tetovës organizuan manifestimin e radhës: “Dita e Poezisë”. Në këtë manifestim të pranishëm ishin Myftiu i Tetovës Qani ef. Nesimi, ish

Myftinjtë e Tetovës, përfaqësues të komunës së Tetovë kolegë të Myftinisë, Dekani i Fakultetit Filozofik pranë Universitetit të Tetovës Ibish Kadriu me disa profesorë të UT-së, hoxhollarët e qytetit të Tetovës me rrethinë, profesorët, profesorëshat dhe disa nga nxënëset e Medresesë “Isa Beu” - Tetovë. Ligjëruesi i këtij programi ishte profesori Elez Ismaili i cili të pranishmëve iu drejtua me temën: “Elementet Kur’anore në letërsinë shqipe, me theks të veçantë në letërsinë e Bejtexhinjëve. Ndërkaq në këtë program u recituan edhe disa poezi nga nxënëset e Medresesë “Isa Beu” paralelja e shtrirë e vajzave në Tetovë: Ky program është përmbyllur me pjesë të zgjedhura nga mendimet e Rexhep Vokës të interpretuara poashtu nga nxënëset e medresesë. Të dielën është organizuar edhe iftari së bashku me komunën e Sulltan Ejup të Stambollit.

KRONIKË

Aksident i rëndë në Tetovë, 3 të lënduar

Tetovë, 27 prill-Një aksident i rëndë komunikacioni ka ndodhur të shtunën rreth orës 11.20 në rrugën e Ilindanit, në udhëkryqin afër Universitetit të Tetovës dhe shkollës së mesme të mjekësisë. Sipas Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë në këtë aksident komunikacioni janë përfshirë dy vetura edhe atë një veturë e tipit Mercedes Benz me targa të Tetovës të cilën e ka drejtuar 23 vjeçari me iniciale A.A nga Tetova si dhe një Reno Megane e drejtuar nga 27 vjeçari me iniciale F.B nga Strimnica. Nga ky aksident dy vozitësit si dhe një bashkëudhëtare që është gjendur në veturën e tipit Renault Megane 28-vjeçarja me iniciale K.B për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në spitalin klinik të Tetovës ku janë mbajtur për shërim të mëtutjeshëm dhe janë jashtë rrezikur për jetën. Nga ky aksident komunikacioni tërësisht është dëmtuar një semafor, një shtyllë metalike, poashtu dëmtime kanë marrë edhe dy veturat të përfshira në këtë aksident. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer një ekip i Sektorit për punë të brendshme në Tetovë dhe po punohet në vërtetimin e shkaqeve, rrethanave në të cilat ka ndodhur, vlerën e përgjithshme të dëmit material dhe gjithçka tjetër që ndërlidhet me aksidentin në fjalë. Jozyrtarisht mësohet se aksidenti në fjalë mund të jetë shkaktuar nga mosdhënia e përparësisë së kalimit dhe mospërshatja e shpejtësisë më kushtet e rrugës njofton Policia e Tetovës.

Arrestohen dy persona, u prezantuan si inspektor

Tetovë, 27 prill-Në vendkalimin kufitarë Jazhincë janë arrestuar dy persona nga Tetova. Behet fjalë për A.Z. 40 vjeçar nga Tetova dhe J.J. 66 vjeçar nga fshati Veshallë. Të dy personat dyshohen se kanë kryer vepër penale, pasi që kanë përdorur dokument të falsifikuar udhëtimi dhe paraqitje të rrejshme gjatë kalimit në kufi ku njëri prej tyre është deklaruar si inspektor policie. Të njëjtit janë dërguar në stacionin policor Tetovë për procedurë të mëtutjeshme dhe zbardhjen e plotë të rastit.

Departamenti i Konunikimit në UET mbledh studjues dhe shkrimtarë në Konferencën Kombëtare Shkencore "Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë"

Nisi ditë e djeshme në Razëm për të katërtin vit Konferenca Kombëtare Shkencore tre ditore "Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë" e organizuar nga Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike e Universitetit European i Tiranës

Gjatë konferencës për letërsinë që është duke u mbajtur në Razëm, do të ketë diskutime nga shkrimtarë e studiues të letërsisë dhe historisë, si Virgjil Kule, Dekani i Shkencave Sociale Dritan Egro, drejtori i Muzeut Kombëtar Dorian Kuci, pedagogë të shkencave sociale, si dhe mesues të letërsisë nga gjimnazet e Shqipërisë.

Si çdo vit konferenca i paraprin shpalljes së çmimit "Kadare" për vitin 2017, një çmim që akordohet nga Instituti European Pashko.

SKËNDERBEU MBLEDH STUDJUES DHE SHKRIMTARË



Çmimi me vlerë 10 mijë euro jepet për të tretin vit radhazi për prozën më të mirë shqipe.

Juria e këtij çmimi përbëhet nga shkrimtari Kim Mehmeti që

është dhe kryetar i saj, gazetarja dhe drejtuesja e emisionit "Studio e Hapur" Eni Vasili, shkrimtarja Ledia Dushi, studiuesi Agim Baçi si dhe pedagogja e studijës në Uni-

versitetin European të Tiranë Genciana Abazi Egro.

Çmimi shpallet të dielën 27 maj në Razëm në përfundim të Ditëve Letrare./Mapo.al/



Man Booker Prize 2018 shkon për romanin "Fluturimet" i shkrimtares polake

Shkrimtarja polake Olga Tokarczuk është fituese e Çmimit Ndërkombëtar "Manbooker" për romanin e saj "Fluturimet".

Libri kombinon histori nga udhëtimet në ditët moderne me tregimet e një anatomisti holandez nga shekulli i 17 dhe me rrëfjen e motrës së Frederik Shopin që transportonte zemrën e tij, pasi kompozitori u nda nga jeta.

Libri fillimisht u botua në polonisht, ndërkohë që përshtatja në gjuhën angleze është bërë nga Xhenifer Kroft, me të cilën shkrimtarja polake Olga Tokarczuk do të ndajë shpërblimin prej 67 mijë dollarësh që shoqëron çmimin prestigjioz.

Manbooker vlerëson çdo vit novelën më të mirë origjinale të shkruar në gjuhën angleze.

Arkivi i Proustit kalon vlerën e 750 mijë eurove në ankand

Arkivat që i përkisnin shkrimtarit francez, Marcel Proust, kanë arritur vlerën e 750,000 eurove, njoftoi shtëpia e ankandeve Sotheby's. Oferta më e lartë është dhënë për një prej kopjeve të para të një prej pjesëve më të bukura të "Du côté de chez Swann", që u shit me 132,500 euro ndërkohë që ishte vlerësuar 30,000-50,000 euro.

Një prej veprave më të diskutueshme ka qenë portreti në laps i Marcel Proust (1871-1922) në shtratin e tij të vdekjes nga Jean-Bernard Eschemann, që ka arritur vlerën e 45,000 eurove ndërkohë që ishte vlerësuar 1,000-1,500 euro.

Një dorëshkrim "A l'ombre



des jeunes filles en fleurs", vlerësuar rreth 15,000-20,000 euro është shitur për 62,500 euros.

Grumbulli prej 138 letrash të Gaston Gallimard për Marcel Proust, vlerësuar rreth 100,000-

150,000 euro, u shit vetëm për 93,750 euro. Në total, rreth 70 pjesë që vinin nga koleksioni i Marie-Claude Mante, mbesa e Proust, u nxorën në ankand. /ATSH



Michele Obama publikon "Becoming"

Ish-zonja e parë amerikane, Michelle Obama ka bërë publike kopertinën e librit të saj të shumëpritur "Becoming". Ky libër është parashikuar të shitet në të gjithë botën më 13 nëntor 2018.

"Jam e emocionuar të ndaj me ju kopertinën e 'Becoming'. Të shkruarit e këtij libri ishte domethënëse dhe iluminues për mua. Ndërsa po publikoj këtë libër, shpresoj që ai të jetë një rast për secilin prej jush që të mendoni për historitë tuaja dhe idetë për të cilat aspironi të bëheni. Historia juaj është diçka për t'u ruajtur", shkruan Michelle Obama.

Autorja do të organizojë një tur promovimi për këtë libër në SHBA dhe nëpër botë.

"Becoming" bën fjalë për një grua e cila sfidoi të gjitha pritshmëritë.

Michele tregon eksperiencat që e kanë formuar, që nga fëmijëria e saj, në zonën South Side në Cikago, deri në periudhën në shtëpinë me të famshme të botës.

Me thjeshtësi ajo përshkruan triumfet dhe zhgënjimet, si ato publike dhe ato private, duke treguar gjithë peripecitë e jetës së saj.

Ekspozitë me veprat e Kolec Topallit

Ekspozita përkujtimore "Kolec Topalli (1938-2018)" vjen si një homazh kushtuar akademikut, gjuhëtarit dhe studiuesit, i cili u nda nga jeta një ditë më parë. Kjo ekspozitë me veprat e studimet e tij vjen për publikun e gjerë dhe lexuesit e Bibliotekës Kombëtare si një vëmendje e veçantë kushtuar kontributit dhe personalitetit të tij të jashtëzakonshëm shkencor të akademik. Duke lënë pas një trashëgimi të vyer në kulturën shqiptare akademik Kolec Topalli është autor i shumë vepra të rëndësishme studimore mbi gjuhën shqipe, monografi, përmbledhje studimesh dhe vepra kolektive si "Theksi në gjuhën shqipe" (1995);

"Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe" (1996); "Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes" (1998); "Shndërrime histo-



rike në sistemin zanor të gjuhës shqipe" (2000); "Fonetika historike e gjuhës shqipe" (2007); "Sonantet e gjuhës shqipe" (2001); "Mbylltoret e gjuhës shqipe" (2002); "Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe" (2003); "Dukuritë fonetike të sistemin bashtingëllor të gjuhës shqipe" (2004); "Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe" (2005); "Ricerche sulla storia

dell'accento in Albanese" (2007); "Evolucioni historik i përemrave të shqipes" (2008); "Sistemi rasor i emrave të shqipes" (2009); "Nyjat e shqipes" (2009); "Sistemi foljor i gjuhës shqipe" (2010); "Gramatikë historike e gjuhës shqipe" (2011); "Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe" (2011) si dhe botimi i tij më i fundit "Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe"

botuar në vitin 2017). Ai gjithashtu ka qenë edhe redaktor dhe recensues i një sërë veprash të rëndësishme studimore si "Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe" i Benedikt Demës; "Vepra të zgjedhura" të Selman Rizës; "Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit: aktet e konferencës shkencore, Durrës, 15-17 dhjetor 2010"; "Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe" i studiueses Anila Omari; "Fonetikë akustike: analizë e sistemit fonologjik" i Aljula Jubanit; "Komisia letrare shqipe në Shkodër (1916-1918) dhe Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip (1879), Shoqëria "Bashkimi" (1899), Shoqëria "Agimi" (1901) dhe "Shekulli i Komisionit Letrar Shqipe në Shkodër: (1916-1918): 100 vjet të rrugëtimet të saj" të autorit Tomor Osmani; etj./Gazeta-Shqip.com

Jerusalemi sipas Traktatit të Omerit

Nga
Rexhep Torte



Zoti Tramp ju jeni milioner dhe president por duhet ta dini se fama arrihet me punë të mira e jo me punë të liga. Unë tërë jetën kam lexuar romane, libra filozofik, historikë, psikologjikë, psikoanaliza dhe lirisht mund të them se fisnikërinë e shpirtit tim dhe të moralit tim e kam arritur vetëm nga librat me tematikë islame. Kjo edukatë më ka bërë që askuj të mos ia bëj edhe të keqen më të vogël. Zoti Tramp duhet ta dini se islami është fe e humanitetit, drejtësisë, paqes e sigurisë. Zoti Tramp duhet ta dini se ndër njerëzit më të shquar në botë Profeti Muhamedi a.s. zen vendin e parë në botë. Ai është i dërguari i Allahut të madhërishtëm të cilit Allahu ja ka shpallur edhe Kur'anin famëlartë. Profeti Muhamed a.s. duke përhapur fenë islame arriti që popujt e atëhershëm që ishin paganë, idhujtarë dhe politeistë të edukojë në popuj me ndjenja humane dhe bëmirese. Zoti Tramp janë evidente kalimet e personaliteteve të shquar nga fetë e tjera në fenë islame, por nuk kemi dëgjuar asnjë rast që një musliman të ketë kaluar në një fe tjetër. Zoti Tramp ardhja e juaj si president i SHBA-ve u karakterizua me afera parazgjedhore, dhe me afera tjera morale të dashurive tuaja me femra të ndryshme. Pas zgjedhjes si president pasuan dorëheqjet e bashkëpunëtorëve tuaj në udhëheqjen e shtetit, si edhe pasuan gafet tuaja në rrafshin dipolmatik. Për dislokimin e ambasadës suaj në Jerusalem me siguri që do ta merrni dënimin e Allahut të Madhërishtëm.

Feja Islame është e shquar dhe e dëshmuar për tolerancën, barazinë, humanizmin dhe drejtësinë. Ajo është e shquar edhe për normat edukative, familjare e shoqërore, si edhe për arsimimin dhe etikën kolektive.

Kjo dëshmohet nëpërmjet Kur'anit famëlartë ku fjala e parë është Ikre-Lexo. Në fenë islame dijetarët janë shtresa më e çmuar e shoqërisë.

Shembëlltjërë konkrete në këtë aspekt paraqet edhe Kalifi Omer ibnul Hatabi i pasqyruar në librin me titull "Omeri ndërtues civilizimi" i autorit Amer Halid i përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

Në këtë libër përbajtësor në mënyrë të argumentuar shkruan se farërat e civilizimit i pat hedhur i dërguari i Zotit, Profeti Muhamed,

ndërsa themelet e këtij civilizimi i vuri hazreti Omer.

Përvojat e Omerit tregojnë se tashmë është koha që muslimanët ta kenë civilizimin e tyre, që nënkupton zhvillimin e dijes, teknologjisë, bujqësisë, ekonomisë, inxhinierisë, arqitekturës, zbulimeve, moralit dhe vlerave shpirtërore për familjen dhe shoqërinë në tërësi dhe besimin te Zoti krijues, që do të jenë shpirti i këtij civilizimi.

FEJA ISLAME E ZBUTI SHPIRTËRISHT OMERIN

Kur Profeti Muhamed u ngarkua me përhapjen e mesazhit të Kur'anit hyjnor Omeri ishte 27 vjeçar, ndërkaq në moshën 32 vjeçare ai e përqafoi islamin. Omeri ishte shtatëgjatë dhe rigoroz e i ashpër në komunikim me njerëzit, por kjo ishte gjersa e pranoi fenë islame.

Omeri në moshën adoleshente mësoi shkrim dhe lexim mjeshtrinë e mundjes dhe shkathhtësitë për luftë. Në moshën 24 vjeçare Omeri u bë anëtar i "Daru Ndue", kuvend i kurejshëve. Në këtë kohë në saj të energjisë dhe pjekurisë së tij ai caktohet ambasador i Mekës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve te fiset arabe. Me

këtë detyrë ai pati mundësi ti nje nga afër karakteret dhe mendimet e popujve si edhe me gjeografinë e këtyre vendeve që më vonë do ta shfrytëzonte për dërgimin e ushtrisë islame. Omeri formoi personalitetin e tij jo duke ndenjtur në shtëpi apo duke luajtur me moshatarët e tij, por duke u marrë me aktivitetet të dobishme. Në këtë mënyrë ai u njoh me civilizimet e kohës ndaj të cilëve do të luftojë dhe do të triumfojë. Ai udhëtoi edhe me karvanet duke u marrë edhe me tregëtinë e mëndafshit me çrast vuri në kujtesën e tij territoret ku më vonë do ti dërgonte ushtritë islame për ti vënë nën kontroll.

Omeri padrejtësinë nuk ia lejonte vetes por as të tjerëve. Ai si person ishte edhe i ashpër dhe kjo ashpërsi u zbut pasi e pranoi fenë islame.

Omeri mendonte se sinqeriteti është çelësi i suksesit dhe rruga për realizimin e ideve.

Omeri ishte pjesëmarrës në betejën e Bedrit dhe Uhudit sëbashku me profetin Muhamed dhe me Ebu Bekrin. Sjelljen me fleksibilitet Omeri e mësoi nga profeti Muhamed me çka fitoi edhe ndjenjën e dhembshurisë, dashurisë dhe hu-

manizmit, që do ti ndihmojnë së tepërmi në kryerjen e punëve të kalfit dhe për ta realizuar idenë e krijimit të civilizimit islam.

Omeri e kuptoi drejt thelbin dhe objektivat e Kur'anit. Omeri e dinte mirë se ndërtimi i civilizimit kërkon motiv dhe motivi më i mirë është përgëzimi i hyrjes në Xhenet. Ai nuk e lexonte Kur'anin sa për ta lexuar, por meditonte dhe analizonte çdo fjalë duke e vënë në praktikë dhe duke kërkuar që edhe besimtarët e tjerë të veprojnë në këtë mënyrë. Si prijës dhe udhëheqës i besimtarëve dhe përgjegjës për vendosje të drejtësisë urdhëroi rregjistrimin e të gjitha foshnjeve në Medine për të cilët caktoi përkrahje sociale nga buxheti i shtetit islam. Gjithashtu urdhëroi të bëhet rregjistrimi i ushtarëve në sa beteja kanë marrë pjesë, cilësitë dhe tiparet e tyre, sa kohë kanë qëndruar larg familjes dhe mbi këtë bazë u caktoi edhe rrogat dhe se ushtarët mund ta vizitonin familjen në periudhën pas katër muajve.

Omeri e kuptoi se shteti duhet të ketë të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet. Ai hodhi idenë e vakëfeve ku pronari mund ta mbante në pronësi pronën, për të cilën pa-

-Jeni shtatëgjatë, i pasur e president, por te Allahu i Madhërishtëm nuk peshoni më shumë se sa një qime floku.

-Në OKB, në muzeumet e Nju Jorkut të Londrës e të Parisit është ekspozuar traktati që në vitin 15 Hixhri, Hazreti Omeri kur i mori çelësat e Kudsit-Jerusalemit u nënshkruajt traktati mes muslimanëve dhe banorëve të Kudsit-Jerusalemit. Ky traktat edhe pse kanë kaluar shekuj me frymën e tij humane dhe demokratike do t'ju bind se jeni duke gabuar.-

-Më 14 maj 2018 mediat njoftuan se është hapur ambasada e SHBA-ve në Jerusalem gjë që shkaktoi një konflikt fatal mes popullatës muslimane duarthatë dhe ushtrisë Israelite të armatosur gjer në dhëmbë si pasojë e së cilës u vranë 59 dhe u plagosën 2700 muslimanë.



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delfev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 27 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

guante të ardhura për disa vite në arkën e shtetit, dhe kështu u krijua ministria e vakëfeve. Omeri krijoi edhe institucionin kontrolli i shtetit për ta luftuar në rrënjë korrupsionin, duke ngritur edhe kutitë e ankësive të popullit. Kutitë e këtitilla për ankësive ai vendosi edhe në Mekë. Omeri mendonte se civilizimi është lidhja mes të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes.

Pas vdekjes së profetit Muhamed vazhdoi angazhimi i Omerit për krijimin e Civilizimit islam, respekti ndaj profetit Muhamed dhe ndaj Kur'anit me qëllim të triumfit të besimit islam.

Kjo tregon se Omeri punonte për interesat e umetit musliman e jo për interesat e tij personale.

Sipas Omerit civilizimi arrihet duke u integruar njëri me tjetrin ngjashëm si ai me Ebu Bekrin.

Në vendet e Shamit (Siria Jordania dhe Libani) Perandoria e Bizantit kishte vendosur një ushtri të madhe dhe sëbashku me Persinë përbënin rrezik të madh për muslimanët. Ebu Bekri dhe Omeri me muslimanët triumfuan sepse luftonin për ndërtimin e civilizimit islam.

CIVILIZIMI ISLAM FILLON ME RESPEKTIMIN E DINJITETIT NJERËZOR

Me emërimin e Omerit si kalif u mbyll edhe konflikti mes Medinasve dhe Mekasve. Omeri këtë e arriti ne sajë të zbatimit të drejtësisë. Ai ndërtimin e civilizimit islam e nisi nga fuqizimi i ekonomisë që njerëzit të jetojnë me dinjitet dhe mirëqenie. Omeri thoshte se muri fortifikues dhe porta e sigurisë së islamit ishte drejtësia. Sipas tij civilizim do të thotë që njeriu të jetojë i lumtur duke u plotësuar nevojat dhe sigurinë e tij.

Omeri thoshte se zullumqarrit do t'ia zhgëryjë fytyrën përtoke dhe do tia vë këmbën sipër derisa tia kthejë të drejtën të vobegëtit. Unë nuk do të abuzoj me pasuritë tuaja, kam detyrim që pasuritë tuaja ti shpenzoj për tua siguruar juve jetën, familjeve tuaja dhe të ardhmen tuaj. Kam detyrim tua shtoj të ardhurat, kam detyrim tua mbroj kufijtë nga armiqët dhe ta vendos rendin e sigurinë në vend, kam detyrim të përcjell mesazhin e profetit tonë gjersa të arrijë në katër anë e botës. Angazhimi i njerëzve me punë ishte objektiv kryesor i Omerit. Ai nga shteti u jepte kredi edhe grave që të meren me aktivitete ekonomike duke shërbyer si shembull edhe për meshkujt për të arritur një ekonomi të fuqishme. Ai caktoi edhe dhënie e zekatit. Rëndësi të posaçme Omeri i kushtoi punimit të tokave, me thënie kush hap tokë të re bëhet pronar i saj. Ai që nuk e punonte tokën 2 vite rrjesht i merrej ajo si pronësi. Omeri krijoi feramat me partneritet. Krijoi "Shtëpinë e pasurisë", ku rruheshin pasuritë e shtetit. Bënte vlerësimin e arritjeve. Jepte për bamirësi dhe për tu ndihmuar



të varfërve. U jepte para pjesëmarrësve në luftëra dhe atyre që e kishin pranuar fenë islame, jepte përkrahje sociale për gratë e moshuara, të veja, për fëmijët bonjakë dhe për familjet me shumë fëmijë. U ndihmonte edhe hebrenjëve dhe të krishterëve të moshuar duke përfshirë edhe koptët në Egjipt.

Omeri thoshte se ndërtimi i civilizimit kërkon besim dhe lidhje të fortë me Zotin.

Omeri i nisi ushtritë islame në Sham, Persi, Egjipt, Irak etj, sepse Bizantët dhe Persët pritin momentin e duhur tu vërsulen muslimanëve dhe se popujt nën sundimin bizantin dhe pers jetonin nën tirani. Omeri për katër vite me komandantët e tij më të mirë dhe me strategjinë e tij i pushtoi këto vende dhe pas kësaj banorëve të këtuashëm u dha toka për ti punuar. Omeri mendonte se çelësi i ndërtimit të civilizimit ishin vlerësimi i gruas dhe i aftësive të saj, gjë të cilën e dëshmoi edhe gjatë luftërave kundër armiqve, ku në prapavijë të çdo ushtrie i caktonte gratë burrëresha të cilat i inkurajonin luftëtarët dhe nuk lejonin që ndonjëri prej tyre ta lëshojë fushëbetejën.

Omeri praktikonte që para se të fillojë luftimet me armiqët të zhvillojë negociatën me dërgimin e ndërsjellë të delegacioneve. Edhe pse biseditet nuk sollën diçka të re muslimanët morrën informacione të bollshme rreth situatës atje. Biseditet u zhvilluan edhe me mbretin Kirsha të Persisë dhe me Herakliun mbretin e Bizantit mesazhi i Omerit ndaj këtyre perandorive ishte që tu tregojë atyre se muslimanët janë ndërtues të civilizimit dhe jo rrënues të perandorive.

Gjatë luftërave me këto dy perandori muslimanët dolën fitues në sajë të guximit, mbështetjes në Zo-

tin komunikimit të rregullt të komandantëve të ushtrisë me Omerin, udhëzimeve të tij strategjike, me dërgimin e ushtrisë pjesë pjesë dhe me kujdesin që ai tregonte për ushtarët dhe për familjet e dëshmorëve të rënë. Sipas kontributit të ushtarëve Omeri ua ndante edhe plaçkën e luftës. Omeri arriti të harmonizojë ekonominë e fuqishme me moralin e fuqishme si vlera që i kishte mësuar nga i dërguari i Zotit.

Civilizimi Islam mbante më vete fuqinë ushtarake, ekonomike, shpirtërore, politike, sociale, kreativitetin, vlerat morale dhe besimin e fortë.

TRAKTATI I PAQES NË KUDS-JERUSALEM SHEMBULL I CIVILIZIMIT ISLAM

Omeri shkoi personalisht për në Kuds-Jerusalem dhe për në xhaminë Aksa që personalisht ti merr në dorëzim çelësat e këtij qyteti. Sipas Omerit një ndër kushtet e ndërtimit të civilizimit është edhe dashuria dhe mbrojtja me fanatizëm e vendeve të shenjta. Kuds-Jerusalemi është termometri i besimit dhe sigurisë në tokë. Nëse Jerusalemi është i stabilizuar e i qetë, e gjithë bota është e tillë. E nëse është i trazuar, e gjithë bota përfshihet nga trazirat. Në Kuds Omerin e pritën tërë banorët. Billalli thiri ezanin dhe të gjithë u falën në xhaminë Aksa, në të njëjtin vend ku ishte falur edhe Profeti Muhamed me profetët e tjerë. Omeri në Kuds-Jerusalem nënshkroi me banorët e këtuashëm një traktat historik, i cili gjendet i vendosur në muzeumet e Londrës, Parisit, Nju Jorkut dhe në OKB. Ky traktat lexohet dhe studiohet nga të gjitha institucionet që interesohen për të drejtat e njeriut, për demokracinë dhe bashkëjetesën. Kushdo që nuk e ka të qartë se çfarë përmban një

traktat human e civilizues le ta lexojë traktatin e Omerit me banorët e Kudsit. Kjo është dhurata më e mirë që mund tu bëhet organizatave për të drejtat e njeriut, për demokracinë dhe për traktatin e OKB-së.

Traktati i Omerit me banorët e Kudsit u nënshkrua në vitin e 15 Hixhri. Të drejtat e përmendura në traktat Omeri ua njihte atyre që e kishin humbur betejën me të, atyre që ishin dorëzuar. Në këtë traktat shkruan, se, "me emrin e Zotit të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirplotit. Kjo është marrëveshje me të cilën rrobi i Zotit Omer ibnul Hatabi, prijës i besimtarëve muslimanë u garanton banorëve të Kudsit-Jerusalem; jetën, pasuritë, kishat dhe kryqet e tyre si dhe gjithçka fetare të tyre. Ai u garanton që kishat e tyre nuk do të përdoren si banesa nga muslimanët, as nuk do prishen dhe as nuk do cënohen. Nuk do u cënohen as kryqet dhe asgjë nga pasuritë e kishave. Ata nuk do të detyrohen të braktisin fenë e tyre dhe as nuk do të dëmtohen".

"Në Kuds, nuk lejohet të banojnë çifutët", ishte një nga nenet e traktatit të Omerit, pasi çifutët kishin bërë disa tentativa për ta shtënë qytetin nën kontrollin e tyre. Ishte kjo edhe kërkesa e vet krishterëve të Kudsit (që asokohe njihej me emrin Ilija).

Vetëm një civilizim madhështor si ai islam, vetëm një civilizim human si ai që e ndërtoi Omeri mund të nënshkruajë marrëveshje të tilla.

Askush nuk është sjellë me muslimanët me të njëjtën mënyrë. Askush nuk ua ka kthyer me të njëjtën monedhë. Kuds-Jerusalemi është dëshmitar, se ky traktat i firmosur nga hazreti Omeri është respektuar gjer në ditët e sotme nga ana e muslimanëve, sepse musli-

manët janë humanistë dhe patriotë, ata besojnë tek vlera e tolerancës dhe e bashkëjetesës.

Këtë traktat largpamës dhe shembullor të Omerit dhe të fesë islame për fat të keq sot janë duke e shkelur me ashpërsinë më të madhe cionistët izraelitë dhe shtetet perëndimore që u ndihmojnë atyre që shiten si shtete të demokracisë, ndërsa kanë okupuar territoret Palestineze, kanë dëbuar 3 milionë palestinezë, duke ndërtuar qendra të reja banimi në territoret Palestineze, duke i dëbuar në vazhdimësi palestinezët nga trojet e tyre dhe duke kryer bombardime të tmerrshme dhe shkatërruese si përgjigje për çdo reagim të palestinezëve ndaj këtyre padrejtësive.

Omeri gjatë periudhës së tij që jetoi i shënoi për 10 vite gjithë këto arritje. Xhamia Aksa u vu nën pushtetin e muslimanëve jo falë një ushtrie, por falë një civilizimi që triumfoi ndaj një civilizimi tjetër. Hazreti Omeri kishte aftësi bashkëjetuese me popujt të besimeve e kulturave të ndryshme, gjë që e kishte mësuar nga profeti Muhamed.

Omeri me kreativitetin dhe kontributin e tij civilizues realizoi shumë reforma dobipurëse në të gjitha vendet që i pushtoi duke zhvilluar, bujqësinë ekonominë dhe tregëtinë.

Drejtësia ishte një segment i rëndësishëm në reformat e Omerit duke filluar nga individit, familja dhe shoqëria. Për këtë arsye Omeri caktoi gjykatat në një vend të posaçëm pranë xhamive dhe në çdo qytet. Historia e njerëzimit ka regjistruar kolosët e shumtë, por asnjëri nuk i afrohet Hazretit Omeri për nga madhështia dhe modestia.

Liderët politikë sot përpiqen që ta fshehin të shkuarën e tyre duke nxjerrë në pah vetëm gjërat e mira. Ndërkaq Omeri mbante qëndrim edukues dhe kritik ndaj egos së tij.

Omeri ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare pas plagosjes me thikë nga një persian i quajtur Fejruz që mbante nofken Ebu Lulue, i cili ishte zënë rob nga ushtria e Omerit i lënë të jetojë i lirë dhe jetonte në Medine. Vdekja e hazretit Omeri shkaktoi një tronditje të madhe mes besimtarëve muslimanë dhe dobësimin gradual të këtyre arritjeve, gjë që ndjehen edhe sot e kësaj dite. Mbetet detyrë dhe obligim i besimtarëve muslimanë që të angazhohen të gjithë si besimtarë për të ndjekur rrugën e hazretit Omeri në rimëkëmbjen e Civilizimit islam në të mirë të njerëzimit.

Këto janë mesazhet e argumentuara që dalin nga ky libër kushtuar Hazreti Omerit si ndërtues i civilizimit islam e mbarënjerezor.

Zoti Tramp traktati i sipërpërmendur i nënshkruar mes muslimanëve dhe banorëve tjerë të Kudsit-Jerusalem është argumenti më përmbajtësor për mëkatën që jeni duke e bërë me rastin e dislokimit të ambasadës së SHBA-ve nga Tel Avivi në Jerusalem.

Shaqiri mbetet në Premier Ligë

Futbollisti shqiptar që luan për kombëtaren e Zvicrës, Xherdan Shaqiri, do ta vazhdojë karrierën e tij në Premier Ligë. Skuadra e tij, Stouk Siti, ra nga kategoria në fund të sezonit që sapo u mbyll, por për sulmuesin shtatshkurtër ka interes nga klube të ndryshme në Angli. Më i interesuar për lojtarin kosovar është Sautemptoni i trajnerit Mark Hjuiz. "The Sun" bën me dije se Shaqiri është objektivi i parë i këtij trajneri dhe pritet që bisedimet të mbyllën me sukses. Sautemptoni kërkon të marrë një lojtar me kualitet, ndërsa Shaqiri sigurisht që do të preferonte të luante sërish në Premier Ligë. Vendimtarë do të jenë termet financiare në këtë transferim.



KOSOVA KRYEN STËRVITJEN E PARË

17 LOJTARË NËN URDHRAT E SHALLANDES

Do të jetë miqësorja e dytë e Kosovës dhe Shqipërisë pas asaj që u zhvillua në Prishtinë në nëntor të vitit 2015, që përfundoi 2-2, ndërsa përfaqësuesja e Kosovës pesë ditë më vonë e zhvillon edhe miqësoren e dytë përballë përfaqësueses shumë të fortë afrikane, Bregu i Fildishtë



Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka zhvilluar gjatë pasdites së të shtunës stërvitjen e parë në Regensdorf të Zvicrës, në prag të ndeshjes miqësore "vëllazërore" me Shqipërinë, e cila zhvillohet të martën me fillim nga ora 20.00. Pasi lojtarët dhe shtabi teknik u bashkuan rreth orës 12.00 në hotel, ku u mbajt një mbledhje e shkurtër në mes futbollistëve dhe trajnerit Bernard Shallandes, në ora 18.00 ishte paraparë edhe stërvitja e parë, në të cilën munguan

disa lojtarë që janë të impenjuar nëpër skuadrat e tyre. Në grumbullimin e parë munguan, Edon Zhegrova, Fanol Përdedaj, Arber Zeneli, Vedat Muriqi, Herolind Shala, Elbasan Rashani dhe Besar Halimi, andaj Shallandes pati në dispozicion vetëm 17 futbollistë, kurse të tjerët do të bashkohen më së largu deri këtë të diel, apo më saktë dy ditë para ndeshjes së parë miqësore ndaj Shqipërisë. Stërvitja kaloi e qetë me një ritëm jo shumë të lartë, pasi lojtarët janë pak të lodhur pas angazhimeve që kishin te skuadrat përkatëse, megjithëse

mjekët e përfaqësueses së Kosovës u ndanë të kënaqur me përgatitjet fizike të futbollistëve, duke deklaruar se janë në gjendje të mirë dhe të gatshëm për lojë. Duhet theksuar se për herë të parë janë grumbulluar edhe katër futbollistë të rinj nga përfaqësuesja U-21 e Kosovës, ndër ta edhe Rron Broja, anëtar i skuadrës shqiptare FC Shkupi, i cili spikati në ndeshjen kundër kampionëve të botës, Gjermanisë. Trajnerin Shallandes po e shqetëson fakti se talentin e madh, Edon Zhegrova, nuk po e inkuadron sa duhet apo fare trajneri i Genkut, Fi-

lip Klement, me të cilin ka pasur një bisedë ditëve të kaluara, kurse ajo që i ka pëlqyer trajnerit zviceran dhe që po punon më së shumti është reparti mbrojtës, i cili në dy miqësoret e para ndaj Madagaskarit dhe Burkina Fasos nuk ka pranuar asnjë gol. Do të jetë miqësorja e dytë e Kosovës dhe Shqipërisë pas asaj që u zhvillua në Prishtinë në nëntor të vitit 2015, që përfundoi 2-2, ndërsa përfaqësuesja e Kosovës pesë ditë më vonë e zhvillon edhe miqësoren e dytë përballë përfaqësueses shumë të fortë afrikane, Bregu i Fildishtë.

TRIUMFON NË KATEGORINË "IFBB ELITE PRO"



Getta Beqa "pushton" Spanjën

Getta Beqa shpallet kampione, fiton kupën në Madrid. Ajo sonte në Madrid ka arritur të zë vendin e parë në garën e fitnesit "IFBB ELITE PRO" në kategorinë "Wellness Fitness". Geta përfaqësoj Kosovën në kategorinë "Wellness Fitness", në garat e fitnesit "IFBB ELITE PRO" të cilat u mbajtën në Madrid nga 26-27 maj. Kjo nuk është pjesëmarrja e saj e parë në garat ndërkombëtare të fitnesit që mbahen në Spanjë dhe duket se paraqitja, imazhi e suksesi i saj ndërkombëtar, ka bindur drejtuesit e këtij shteti iberik të lënë menjë anë bindjet e tyre politike karshi Kosovës. Vitin e kaluar, Geta arriti të dalë e para në kampionatin botëror dhe atë evropian. Suksesi i arritur ka bërë që garuesja Kosovare të merr edhe oferta të ndryshme për të stërvitur sportistë anembanë globit.

Kuqezinjtë në pushim deri më 10 qershor

Shkup, 27 maj - Kampioni i Maqedonisë dhe fituesi i Kupës, KF Shkëndija është në pushim të merituar veror. Kuqezinjtë fituan një sërë rekordesh, ndërsa edhe në Kupë nuk u shfaq një rival i denjë për të ndalur djemtë e trajnerit Osmani. Me dy trofetë që përfunduan në Tetovë, skuadra ka realizuar foto sesion. Atmosfera pozitive dhe batuta

ndërmjet grupit karakterizuan atmosferën gjatë realizimit të foto sesionit, ndërsa futbollistët pozuan edhe individualisht me trofetë e kampionatit dhe Kupës. Nga klubi kuqezi njoftuan se faza përgatitore do të nisë më 10 qershor, ndërsa faza kryesore do të zhvillohet në Slloveni ku janë paraparë edhe tre ndeshje kontroluese si përgatitje para paraqitjes



NË SHKUP ZHVILLOHET BALOTAZHI I PARË MES GOSTIVARIT DHE BORECI

JAKUPI: DO TË PLASOHEMI NË BALOTAZHIN E DYTË

Shkup, 27 maj - Në kompleksin sportiv të Federatës Futbollistike të Maqedonisë sot (e hënë) në ora 16:30, do të zhvillohet ndeshja e balotazhit mes Gostivarit si nënkampion në grupin e perëndimit dhe Borecit të Velesit, nënkampion në grupin Lindje. Fituesi nga ky takim do të përballlet me Pobodën e Prilepit për të plotësuar vendin e zbrazët në elitën e futbollit vendor. Për këtë sfidë, ka folur trajneri Mensur Jakupi. Ai për gazetën KOHA, ka

treguar se si kanë rrjedh përgatitjet për këtë sfidë mjaft të rëndësishme si dhe cilat janë pritjet e tij. "Përgatitjet kanë kaluar në një atmosferë të mirë. Futbollistët me padurim e presin ndeshjen dhe në përjashtim të Edin Mersosit (i lënduar), por që në anën tjetër rikthehet Ersin Fetaj, të gjithë futbollistët tjerë janë të përgatitur maksimalisht për këtë sfidë", u shpreh Jakupi. "Sigurisht se do të jetë një ndeshje e rëndë duke marr parasysh rëndë-

sinë e ndeshjes. Edhe kundërshtari, pra skuadra e Borecit është një skuadër shumë cilësore. Besoj se ekipi jonë për momentin është në formë të mirë dhe këtë do ta vërtetojmë në ndeshjen e sotme dhe do të plasohemi në balotazhin e dytë dhe përballjen me Pobodën nga Prilepi", deklaroi për gazetën KOHA, Jakupi. Ndërkohë, Jakupi dhe futbollistët në këtë përballje nuk do të jenë vetëm, por do të kenë përkrahjen edhe të grupit të tifozëve "Ka-



striotët", të cilët në mënyrë të organizuar do të vijnë në Shkup, për

të përcjell ekipin e tyre të zemrës. (B.K.)

BEJLL "SHOW", POR KARIUS BËN "MASAKËR"

REALI SHKRUAN HISTORINË NË ÇAMPIONS

Real Madridi ka fituar për herë të 13-të trofeun e Champions League pasi mposhti 3-1 Liverpoolin në finalen e luajtur në Kiev. Ky ishte sukseksi i tretë radhazi në veprimtarinë më prestigjioze për klube, i katërti në pesë vitet e fundit. Rekord historik edhe për trajnerin Zinedin Zidan, që e fiton "Champions" për herë të tretë radhazi, si askush tjetër në të kaluarën



Në një pjesë të parë krejtësisht të ekuilibruar episodi kyç i ndeshjes ndodhi kur u mbush gjysmë ore lojë. Ramos dëmtoi Mohamed Sallah, duke nxjerrë shpatullën e egjiptianit, në një aksion ku nuk u dha as faull dhe do të diskutohet për një kohë të gjatë nëse spanjoli e bëri qëllimisht apo jo. Në minutën e pestë të pjesës së dytë, Real Madrid kaloi në avantazh, duke përfutur nga gabimi foshnjarak i portierit Karius. Ky i fundit e përplasi topin në këmbët e Karim Benzema, për habinë e të gjithëve. Ky ishte goli i parë i një francezi në Çampions, që pas Zidan në vitin 2002. Gjithsesi, katër minuta më vonë, gjatë një goditje nga këndi, anglezët u përgjigjën me barazimin e shënuar nga Saido Mane. Baraspesha zgjati deri në minutën e 64-t, kur erdhi "perla" e Bejll. Pas krosimit të Marcelo, uelisi, që kishte vetëm tre minuta në fushën e lojës, shënoi me roveshatë një gol të mrekullueshëm, ndoshta më të bukurin në historinë e finaleve të Çampions League. Nëntë minuta para fundit, një gafë tjetër qesharake nga Karius vulosi fatet e ndeshjes. Bale goditi nga rreth 30 metra dhe topi përfundoi në rrjetë, pasi duart prej "galpi" të portierit të Liverpoolit nuk mundën të ndalin topin. Një paraqitje skandaloze e tij.

SALLAH RREZIKON BOTËTORIN

Lotët e Mohamed Sallah që lë fushën e lojës në minutën e 30-të, ishin një dëshpërim jo vetëm për lojtarin dhe tifozët e Liverpoolit, por edhe për egjiptianët, që rrezikojnë të mos kenë në Botërorin "Rusi 2018" liderin e tyre. Frika se mos Sallah do të mungojë në Botërorin që nis pas 3 javësh është e madhe, gjë që konfirmohet edhe nga trajneri i "reds", Jurgen Klopp. "Dëmtimi i Sallah është serioz.

Menjëherë pas ndeshjes ai shkoi në spital për të bërë disa analiza, presim përgjigjen, por shpatulla ose klavikula me shumë gjasa janë të thyera. Për fat të keq, Botërori mund të jetë në rrezik për të", tha Klopp.



qarë për gafat. "Nuk ndihem mirë. Isha unë ai që ia humba ndeshjen skuadrës time dhe ndihem keq për këtë gjë. I kërkoj falje të gjithëve, skuadrës, trajnerit, tifozëve. Gabimet e mia i kushtuan shumë rëndë skuadrës. Nëse do të kisha mundësi do të kthehesha pas në kohë. Ndihej shumë keq, pasi e di që i lashë në baltë në këtë finale, në këtë ndeshje të madhe. Por kjo është jeta e një portieri, tani duhet të gjej forcat për të ecur përpara", u shpreh portieri Karius.

BEJLL I LUMTUR PËR GOLAT, POR KËRCËNON ME LARGIM

"Goli i parë që realizova në finalen e Çampions është padyshim goli më i bukur i karrierës time", ka deklaruar Bejll, protagonist i fitores së Real Madridit në finalen ndaj Liverpoolit. Por kjo



mbremje magjike nuk e ka kënaqur aspak sulmuesin 29-vjeçar, madje ai ka qenë i zhgënjyer, pasi priste të luante titullar, ndërsa Zidan e la në stol. "Mendoj se e meritoja të isha në fushë nga minuta e parë. Ndaj doja që t'i tregoja të gjithëve se jam i aftë të shënoj dhe të jem vendimtar, ashtu si dhe ndodhi", tha Bejll. "Jam i kënaqur me fitoren, por nëse nuk luaj shpesh do të shoh alternativa të tjera për të ardhmen time. Ishte një sezon i mirë, por do të dëshiroja të luaja më shumë. Nuk e di se cila do të jetë e ardhmja ime, do të flas me menaxherin tim dhe do të diskutojmë se cila është mundësia më e mirë për mua. Unë kam nevojë të luaj", deklaroi Bejll, që ka realizuar tre gola në karrierën e tij në finalen e Çampions.

RONALDO I KËNAQUR, POR KONFIRMON LARGIMIN

Çampions Liga duhet të ndryshojë emrin dhe të quhet 'CR7 Champions League'. Unë kam fi-

tuar pesë, kam qenë përsëri gola-shënuesi më i mirë, nuk mund të mos jem i kënaqur", u shpreh Ronaldo pas ndeshjes. Mirëpo, deklarata e dhënë nga portugezi menjëherë pas fitimit të "Champions League", ku tha: "Ishte diçka e bukur të luaja me Real Madridin" duket se nuk ka qenë një koment i thënë nxitimthi nga sulmuesi portugez. Një ditë pas finaleve, Ronaldo ka folur sërish për mediat, duke sqaruar se ajo deklaratë nuk ka qenë rastësi, por duket se pas saj fshihet diçka tjetër. "Ndoshta nuk ishte momenti i duhur për ta bërë atë deklaratë, por isha i ndershëm dhe nuk jam penduar për atë që thashë. Është e qartë që kam diçka për të thënë, por do të flas më gjatë ditët në vijim. Kjo është një çështje që ka kohë që ka nisur dhe paratë nuk janë aspak problem. Do të



kem një javë kohë për të menduar për të ardhmen time para se të përqendrohem të kombëtarja dhe Botërori", tha Ronaldo sot në mëngjes.

KLLOPP: DËMTIMI I SALLAH TRONDITI SKUADRËN

Pasi Liverpooli nuk arriti të fitojë trofeun e 'Champions League', ka folur trajneri Jurgen Klopp, i cili ka rrëfuar këtë dështim. "Dëmtimi i Sallah është serioz, ishte një ngjarje që na tronditi të gjithëve, i preu krahët ekipit. Pjesën e parë të ndeshjes e luajtëm mirë, patëm edhe raste shënimi. Megjithatë, asnjë nuk do të flasë se përse u mundëm, pasi të gjithë do të flasin për festën e Realit", tha trajneri gjerman i "reds". Duke folur për gafat e portierit Karius, trajneri Klopp shprehet. "Pësuam disa gola qesharake, ndërsa ai me roveshatë ishte fantastik. Në futboll duhet edhe fat për të fituar, por në këtë finale nuk e patëm me vete, madje e patëm kundër. Po luanim ashtu si ne dimë, por më pas rrjedha e lojës mori një rrugë tjetër, me fatin që na u përplas kundër. Donim të merrnim gjithçka në këtë finale, por për fat të keq nuk morëm asgjë", deklaroi Klopp.

ZIDAN: ENDE NUK E KEMI KUPUTUAR MIRË SE ÇFARË KEMI ARRITUR

Trajneri i Real Madridit, Zinedin Zidan ka thënë se ekipi ende nuk e ka kuptuar se çfarë kanë arritur në Ligën e Kampionëve. "Mbretërit" hyn në histori si ekipi i parë që e fiton trofeun evropian tre herë rresht dhe 13 herë, më shumë se çdo klub tjetër në Evropë. "Emocione të mëdha. Është e mrekullueshme ta fitosh trofeun e Ligës së Kampionëve tre herë rresht. Ende nuk e kemi kuptuar mirë se çfarë kemi arritur. Do ta shijojmë këtë moment. Kishim sezon të komplikuar, por e përfunduam shumë të lumtur", ka thënë Zidan.

RAMOS ME MESAZH EMOCIONUES PËR SALAHUN

Të gjithë e akuzuan Ramosin se e lëndoi me qëllim Sallahun, por mbrojtësi spanjoll ka reaguar pas finaleve me një status në "Twitter". "Futbolli ju mëson fytyrën më të ëmbël por edhe anën tjetër që është e hidhur. Para se gjithash ne jemi shokë. Shërim të menjëherëshëm Sa:lah, e ardhmja ju pret", ka shkruar Ramos.



KARIUS KËRKON FALJE: E VËSHITIRË TË VAZHDOJ PËRPARA

Bejll, Real por edhe Loris Karius. Portieri i Liverpoolit ka qenë protagonist në finalen e humbur ndaj Realit, për dy gafat e tij në dy golat e realizuara nga skuadra "merengues", që në fund fitoi 3-1. Pas ndeshjes, portieri i ka kërkuar falje fansave të tij, me kërkën ulur dhe duke



DUA LIPA, "MBRETËRESHA" E CEREMONISË HAPËSE

Dua Lipa realizoi një performancë elektrizuese në ceremoninë hapëse të finaleve së "Champions League", mes Real Madrid-Liverpul, që luhet në Kiev. Këngëtarja me origjinë kosovare këndoi disa prej këngëve të saj, që tashmë janë shndërruar në hite. Mes tyre edhe "Neë love", "IDGAF". Nuk mungoi as bashkëpunoi me Sean Paul, "No Lie". Dua Lipa e mbylli super performancën e saj me hitin që i dha shumë çmime dhe rekorde, "Neë Rules".



ZBULOHEK PLANI I TRAJNERIT ITALIAN NËSE EMËROHET TRAJNER I ÇELLSIT KULIBALI DHE HIGUAIN JANË ËNDRRAT E SARRIT



Hart, pasuesi i De Geas

Mbrojtësi i Napoli ka një kontratë deri në vitin 2021 me klubin e Aurelio De Laurentiis dhe e ka pagën 2 milionë euro, ndërsa klauzola për shitjen e tij jashtë Italisë është 70 milionë euro, derisa nga Juve thonë se Higuain nuk është në shitje, por nëse Çellsit ofron 70 milionë euro, atëherë situata do të ndryshojë



euro për ta marrë nga Genk në vitin 2014. Nën urdhrat e Sarri, Kulibali është bërë një nga mbrojtësit më të mirë të Serie A dhe idhull i tifozëve pas golit të shënuar ndaj Juventusit. Kapitulli Higuain! Beppe Marotta ka thënë se argjentinasit nuk është në shitje, por nëse Çellsit ofron 70 milionë euro, atëherë situata do të ndryshojë. Pra, "El Pipita" dhe Kulibali mund të kushtojnë së bashkë rreth 150 milionë euro, në sforcë që Çellsit mund të bëjë për të kënaqur trajnerit. Alternativat janë shqiptari Elseid Hysaj dhe Robert Levandovski i Bajernit. Edhe në këtë rast do të duhen 140 milionë (50 për Hysaj, rreth 90 për polakun).

Hoze Murinjo duket se nuk do të ketë më në dispozicion sezonin e ardhshëm portierin argjentinas Sergio Romero, që gjatë gjithë këtyre viteve ka qëndruar në stol, duke qenë zëvendësi i David De Gea. Për këtë arsye, trajneri portugez ka piketuar portierin e kombëtares britanike Xho Hart si zëvendësuesin e tij, për ta sjellë në "Old Trafford" dhe për të luajtur detyrën e "portierit të dytë". Hart, 31 vjeç, nuk ka kaluar një sezon të mirë te skuadra e Uest Hem, duke qenë shpesh në stol, madje duke humbur edhe vendin në kombëtaren. Portieri britanik ka humbur shkëlqimin e dikurshëm që kur prishi marrëdhëniet me trajnerin Pep Guardiola te Mançester Siti, që e la në stol dy sezone më parë, duke e detyruar të largohet, fillimisht në Torino e më pas te Uest Hem. Por, duket se aventura e Hart te "Hammers" nuk do të zgjasë shumë, ndaj është gati të rikthehet në Mançester, këtë herë tek skuadra e Junajted, ku sërish pritet të përfundojë në stol dhe do të luajë shumë pak. Por, Hart ka edhe disa oferta të tjera, si nga Sautemptoni apo VBA, që janë gati ta marrin portierin.

Maurizio Sarri te Çellsit do të ketë një mision të qartë, ta rikthejë këtë ekip në "Champions League" dhe të luftojë për titullin. Mbërritja e ish-trajnerit të Napoli në Londër do të hap skenarë të

reja në merkato. Pikërisht me kërkesë të tij, Roman Abramoviç ka vendosur të investojë për blerjen e Kulibali dhe Higuain, dy lojtarët "e adhuruar" nga Sarri. Mbrojtësi i Napoli ka një kontratë deri në vitin 2021 me klubi

bin e Aurelio De Laurentiis dhe e ka pagën 2 milionë euro, ndërsa klauzola për shitjen e tij jashtë Italisë është 70 milionë euro. Për Napoli do të ishte një fitim i jashtëzakonshëm ekonomik, duke parë se shpenzoi vetëm 8 milionë

Parma ka një ëndërr, quhet Balotelli

Parma u rikthye në Serinë A, pas 3 sezonesh mungesë, gjatë të cilave bëri kapërcimin e madh nga Seria D, ku u dërgua për të luajtur, pasi shpalli falimentin. Klubi emilian po mendon të përforcohet në kuadër të sezonit të ri, ku synimi madhor është sigurimi sa më shpejt i mbijetesës. Së fundi ka dalë

në skenë emri i Mario Balotellit, sulmuesit të saporikthyer te Italia, që mund të transferohet te emilianët, duke filluar që nga kjo verë. Balo do të largohet me parametra zero nga NicA, ndërsa Parma ka gati një ofertë të kënaqshme ekonomike, ku kërkon të synojë edhe dëshirën e lojtarit për të luajtur me

emilianët. Sulmuesi i bashkuar festës së ngjitjes së Parmës në Serinë A, duke shpërndarë dedikime në rrjetet sociale, ndërsa menaxheri i tij, Mino Raiola ndodhet prej dy ditësh në Parma, ku ka takuar edhe drejtuesin sportiv të vendasve. Mbetet për t'u parë se çfarë do të ndodhë në ditët në



vijim, pasi për Balotellin është e interesuar edhe Roma, por edhe skuadra tjera italiane e angleze.

Publicitet

KOMUNA E KËRÇOVËS

Në bazë të Ligjit për Shoqata dhe fondacione ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 52/2010), Komuna e Kërçovës dhe Programi për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2018, të sjellur nga ana e Këshillit të Komunës së Kërçovës, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018, të destinuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018, në pajtim me Programin për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal, mjetet e caktuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve, do të bëhet në bazë të kritereve dhe prioriteteve të dhëna në këtë thirrje.

1. Lloji i projekteve që do të mbështeten

Mjetet nga Buxheti i Komunës së Kërçovës, do të shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve, për projektet që ndikojnë në kapacitetin e shoqatave dhe OJQ-ve të cilat punojnë ekskluzivisht në sferën e përmirësimit të kushteve për jetesë të personave të marginalizuar social, persona me nevojë të posaçme dhe të njëjta. Me këtë thirrje, do të mbështeten vetëm shoqatat dhe fondacionet të cilat janë të regjistruara si të këtuara dhe ata që kanë DORËZUAR raport për realizimin e aktiviteteve programore, në qoftë se kanë qenë shfrytëzuese të mjeteve nga buxheti i komunës për vitin fiskal paraprak. Shoqatat dhe fondacionet duhet të ofrojnë projekte kreative dhe inovative me projekte ideale dhe përmbajtjesore.

2. Mjetet e parapara - Për financimin e aktiviteteve programore të ofruara, në pajtim me këtë thirrje, do të shfrytëzohen mjete nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018 në shumë prej 500.000,00 den., ndërsa çdo shoqatë mund të aplikojë me projekt për përkrahje të aktiviteteve të saja me kërkesë për mjete financiare në lartësi deri më 50.000,00 den. Komuna e mban të drejtën që ta vlerësojë nevojën reale dhe arsyetimin e buxhetit të dorëzuar dhe të ndaj mjete, në pajtim me vlerësimin vetanak dhe metodologjisë.

3. Dorëzimi i raportit - Shoqatat dhe fondacionet të cilave do t'u jepen mjete në pajtim me Programin, pas përfundimit të aktiviteteve të tyre programore, do të dorëzojnë Raport për shfrytëzimin e mjeteve në Njësinë për ZHEL dhe Sektorin për financa në Komunën e Kërçovës.

4. Kriteret themelore organizative - Kriteret themelore organizative që duhet t'i përmbushin shoqatat dhe fondacionet që do të marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruara sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione
- Të merren me aktivitete dhe projekte me interes publik

5. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqatat / fondacionet duhet ta dorëzojnë me Fletëparaqitjen për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në shpallje, duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për përkrahje financiare
2. Propozim-projekt
3. Statut dhe Aktvendim për regjistrimin e shoqatës ose fondacionit

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Afati për dorëzimin e paraqitjeve është 20 (njëzet) ditë, nga dita e shpalljes në gazetën ditore dhe në web faqen e Komunës së Kërçovës.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e tërësishëm, të dorëzohet përmes postës, në adresën:

Komuna e Kërçovës rr. "Boris Kidriç" nr. 1, 6250 Kërçovë, ose në Arkivin e Komunës së Kërçovës nga ora 08:00 deri më ora 16:00, me përshkrimin – Për përkrahje të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2018.

Shoqatat dhe fondacionet pjesëmarrëse në thirrjen publike, do të jenë të informuara për rezultatet pas shpalljes së vendimit për shpërndarjen e mjeteve në "Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës". Emrat e shoqatave dhe fondacioneve të cilat kanë fituar mjete për projektet, do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Kërçovës. Fletëparaqitjet për përkrahje financiare të shoqatave dhe fondacioneve, si dhe Ekzemplari për Propozim-projektin, do të mund të merren në Arkivin e Komunës së Kërçovës dhe në ueb faqen www.kercova.gov.mk

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74 të datës 08.05.2015), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-2786/2 të datës 08.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 385-0201 të datës 22.05.2018 nga U.D Drejtori i IPSH Qendra për shëndet publik – Koçan, publikohet

SHPALLJE PUBLIKE

për punësimin e 4 (katër) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar

1. IPSH Qendra për shëndet publik – Koçan ka nevojë për punësim të:
 - 1.1 4 (katër) doktorë të medicinës për kohë të pacaktuar
2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
 - të mos jetë të shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

Për kandidatin nën pikën 1.1

 - Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të Fakultetit të medicinës,
 - provim të dhënë profesional,
 - licencë për punë,
 - me ose pa përvojë pune.
4. Orari javor i punës është 40 orë në javë. Neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës është 26.000,00 denarë.
5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:

Për kandidatin nën pikën 1.1

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- biografi të shkurtë (CV)
- diplomë me sukses mesatar
- dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane)
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
8. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohet deri në IPSH Qendra për shëndet publik – Koçan, rr. Millan Zeçar nr. 21, përmes postës ose në arkivin e IPSH Qendra për shëndet publik – Koçan, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Qendra për shëndet publik – Koçan

Ndërkohë që MekGregor ka ende disa "beteja" ligjore për të zgjidhur në qershor, Khabib vazhdon të thumbojë irlandezin dhe t'i hedhë benzinë zjarrit. Së fundi, rusi ka polemizuar me MekGregor duke e quajtur të papërgjegjshëm për veprimet që bën, por edhe e fton në duel

NURMAGOMEDOV MESAZH MEKGREGOR

HERËS TJETËR DERA E AUTOBUSIT DO JETË E HAPUR



Të gjithë presin që dueli i peshës së lehtë mes ish-kampionit të botës Konor MekGregor dhe kampionit aktual Khabib Nurmagomedov të ndodhë sa më shpejt, dy sportistë që duket se nuk kanë marrëdhënie të mirë mes tyre, sidomos pas incidentit me autobusin në Bruklin, para evenimenti të UFC-223. Ai incident ka ndodhur në prill, por koha ecën shumë shpejt dhe ajo ka treguar se kjo përballje është pranë, duke parë edhe deklaratat që dy sportistët kanë dhënë herë pas here. Ndërkohë që MekGregor ka ende disa "beteja" ligjore për të zgjidhur në qershor, Khabib vazhdon të thumbojë irlandezin

dhe t'i hedhë benzinë zjarrit. Së fundi, rusi ka polemizuar me MekGregor duke e quajtur të papërgjegjshëm për veprimet që bën, por edhe e fton në duel. "Kur ta shihni, i thoni: Konor, tani lojërat kanë ndryshuar dhe duhet të sillësh si një i rritur. Herës tjetër nuk do të ketë më një autobus të mbyllur,

me roje sigurie brenda dhe jashtë tij. Tani duhet ta zgjidhësh atë problem i vetëm. Nëse nuk do, mjafton ta thuash, të gjithë do ta kuptojnë", ka shkruar Khabin Nurmagomedov, që mban titullin e peshës së lehtë, pas fitores ndaj Al Iaquinta në UFC-223. Jo vetëm kaq, por rusi ka edhe rekordin e 26 fitoreve dhe

asnjë humbje në kafaz në karrierën e tij, ndërkohë që ditët e fundit qarkullojnë zërat se kanë nisur bisedimet për një duel mes Khabib dhe MekGregor. Irlandezi nuk duhet të jetë në kafaz që prej nëntorit të 2016-ës dhe gjatë kësaj kohe UFC-ja ia ka hequr të dy titujt kampionë që ka pasur.



Në Milano më mungoi familja dhe deti

Verën e kaluar u transferua me shumë bujë nga Porto te Milani, por Andre Silva nuk arriti të përmbushë pritshmëritë, duke u klasifikuar në listën e dështimeve të merkatos. I cilësuar si Cristiano Ronaldo i ri, sulmuesi portugez arriti të shënojë vetëm dy gola në 24 takime me Milanin në Serisë A, duke mos arritur dot të përshtatet. Këtë fakt e pranoi edhe vetë Silva, që në një intervistë për mediat portugeze, zbuloi shkaqet e dështimit në këtë sezon të parë në Itali. "Ishte hera e parë që largohesha nga familja, dhe nga deti. Pikërisht këto dy gjëra më mungonin më shumë në aventurën time në Milano. Përshtatja është e vështirë, pasi bëhet fjalë për shokë të rinj, gjuhë tjetër, sjellje të tjera, kulturë tjetër ushqyerjeje, etj", u shpreh sulmuesi portugez. Aktualisht menaxheri i tij Jorge Mendes po punon me drejtuesit e klubit të Milanit, për të gjetur një tjetër skuadër për sulmuesin, që ka oferta nga Spanja dhe Anglia.

RRËFEHET SIMONA HALEP

Zvogëlimi i gjoksit, sakrifica më e madhe e jetës time

Tenistja rumune Simona Halep, numri 1 në botë për femra, në prag të grand slemit të "Roland Garros" që nis ditën e hënë, ka rrëfyer për mediat se karriera e saj dhe rezultatet në fushë ndryshuan në momentin që vendosi të marrë një vendim drastik: Të zvogëlojë madhësinë e gjoksit. "Kur e mora atë vendim dhe kreuva operacionin plastik, gjithçka e bëra për karrierën time, për tenis", thotë Simona Halep. 26-vjeçarja pranon

se dikur e kishte më të vështirë të luante edhe pse ishte vetëm 20 vjeçe, por pasioni për sportin e tenisit e detyroi që të ndërhynte në trupin e saj, duke kryer disa operacione. "Ndoshta ky ndryshim në pamjen time fizike ishte vërtet e rëndësishme për të arritur këtë rezultat, për të qenë numri 1 në botë. Kjo ka qenë sakrifica më e madhe e jetës time, por ia ka vlejtur", deklaroi Simona Halep.



Publicitet

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18) nga Statuti i Shkollës fillore "Nikolla Parapunov" – Dragobrashte, ndërsa në pajtim me Vendimin nr. 10-534/2 të datës 15.05.2018 të sjellë nga Kryetari i Komunës së Vinicës, Këshilli i shkollës pranë SHF "Nikolla Parapunov" – Dragobrashte publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

Kandidati për drejtor të shkollës krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore.
 Të ketë të dhënë provimin për drejtor.
 Të ketë të dhënë testin psikologjik për integritet.
 Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 Me përjashtim nëse nuk paraqitet kandidati me provim të dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi me provim jo të dhënë për drejtor por obligohet të njëjtin ta japë në afat prej një viti nga zgjedhja për drejtor.
 Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:
 Fletëparaqitje me biografi të shkurtë (CV)
 Program për punë për periudhë prej 4 vjet
 Diplomë për arsim të mbaruar sipëror
 Vërtetim për përvojë pune në institucion edukativo-arsimor
 Certifikatë për provim të dhënë për drejtor
 Certifikatë të shtetësisë
 Vërtetim për test të dhënë psikologjik për integritet
 Certifikatë se në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
 Shpallja publike zgjatë 8 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit.
 Orari i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07.00 deri në ora 15.00.
 Shuma në të holla e neto pagesës fillestare është 25.000 denarë.
 Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve prej ditës së përfundimit të shpalljes.
 Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter të parashtrihen deri te: Këshilli i shkollës pranë SHF "Nikolla Parapunov" Dragobrashte personalisht ose përmes postës në zarf të mbyllur me shenjë – për shpalljen e publikuar për drejtor.
 Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrua pas afatit nuk do të merren parasysh.
 Me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet do të realizohet intervistë, për çka do të informohen enkas.
 Telefoni 033 375 442

SHF "Nikolla Parapunov" – Dragobrashte
 Këshilli i shkollës
 Kryetar
 Zdravko Marinkov

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor, nenit 71 paragrafi 1 alineja 7 e Statutit të SHF "Koço Racin" Bllatec dhe Vendimit nr. 10-543/2 të datës 15.05.2018 të sjellë nga Kryetari i Komunës së Vinicës, Këshilli i shkollës pranë SHF "Koço Racin" – Bllatec publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

Kandidatët krahas kushteve të parapara me LMP, duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:
 - Të ketë arsimin sipëror, të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional;
 - Të ketë pesë vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga MASH;
 - Të ketë të dhënë provimin për drejtor.
 - Të mos jetë i dënuar për vepra penale që e bëjnë atë të papërshtatshëm për kryerje të punës edukativo-arsimore;
 - Të ketë të dhënë testin psikologjik për integritet.
 Me përjashtim nëse nuk paraqitet kandidati me provim të dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi me provim jo të dhënë për drejtor por obligohet të njëjtin ta japë në afat prej një viti nga zgjedhja për drejtor.
 Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:
 - CV dhe letër motivimi;
 - Diplomë për arsim të mbaruar sipëror;
 - Vërtetim për përvojë pune në institucion edukativo-arsimor;
 - Program të shkurtër të punës (për 4 vjet);
 - Certifikatë të shtetësisë
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se gjashtë muaj;
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
 - Vërtetim për test të dhënë psikologjik për integritet

Orari i punës së drejtorit do të jetë prej ora 07.00 deri në ora 15.00, ndërsa neto pagesa fillestare do të jetë 25.043 denarë. Vendi i punës është me kompetenca të posaçme.
 Dokumentet mund të parashtrihen personalisht ose përmes postës në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter me shenjë deri te Këshilli i shkollës së SHF "Koço Racin" – Bllatec, në zarf të mbyllur me shenjë – për shpalljen e publikuar për drejtor.
 Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrua pas afatit nuk do të merren parasysh.
 Shpallja zgjatë (8) ditë ditë nga dita e publikimit. Intervistë do të realizohet me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet, për çka do të informohen enkas. Zgjedhja do të realizohet brenda afatit të paraparë të caktuar ligjor.
 Telefoni 033 371 319

SHF "Koço Racin" – Bllatec
 Këshilli i shkollës
 Kryetar
 Mihaella Voinova

PASOJA E "ZAJEDNICËS": KISHA SERBE NDALON PUNIMET E NDËRTIMIT TË RRUGËS DEÇAN-PLAVË

Sa i përket pronave të dhuruara nga shteti gjenocidal serb i udhëhequr nga Sllobodan Millosheviq në vitin 1994-1997 e të cilat ju dhanë edhe me vendimin te gjykatës Kushtetuese të Republikë së Kosovës, vlerësojmë se Manastiri i Deçanit është dashur këtë pronë ta kërkoj vetëm nga qytetarët e Komunës së Deçanit, thueht në reagimin e Komunës së Deçanit

Misioni i OSBE-së konfirmoi se punimet në ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë janë ndërprerë, pas kërkesës së Manastirit të Deçanit. Në një komunikatë të lëshuar, Misioni i OSBE-së tha se ka ndjekur me shqetësim atë që Misioni tha se dukej të ketë qenë ndërtimi ilegal i rrugës, që nga dita e djeshme, brenda Zonës Speciale të Mbrojtur (ZSM) të Manastirit të Deçanit.

"Ne rikujtojmë se çdo punim brenda ZSM-së duhet të bëhet në marrëveshje me Këshillin Implementues dhe Monitorues. U bëjmë thirrje të gjithë faktorëve për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët në përputhje me ligjin e Kosovës dhe obligimet ndërkombëtare", thuhet në deklaratën e Misionit.

Vendimi për ndaljen e punimeve është përshëndetur edhe nga Manastiri i Deçanit.

"Duke iu falënderuar iniciativa-



te (të bashkësisë) ndërkombëtare, qeveria e Kosovës ka ndaluar punimet e paligjshme në rrugën brenda Zonës së Mbrojtur dhe makineria e rëndë është larguar. Shpresojmë që qeveria e Kosovës në të ardhmen do t'i repsekojë ligjet e veta dhe obligimet ndërkombëtare", thuhet në një deklaratë të Manastirit të Deçanit të lëshuar në Twitter.

Edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, doli në mbështetje të vendimit për ndalim të punimeve. "SHBA-ja pajtohet plotësisht me deklaratën e OSBE-së", tha Delawie në një postim në Twitter.

Gjatë ditës, komuna e Deçanit kishte reaguar ndaj një kërkesë të Manastirit të Deçanit për ndërprerjen e punimeve.

"Me 24 prill punimet në rrugën Deçan Bjeshka e Belegut- Kufiri më Malin e Zi kanë filluar jashtë zonës së veçantë të mbrojtur. Me këtë rast Komuna e Deçanit dhe Ministria e Infrastrukturës janë garantues që ky projekt do të vazhdoi jashtë zonës së mbrojtur deri sa të arrihet një vendim nga KZM (Këshilli për Zbatim dhe Monitorim), ku përfaqësues në këtë këshill për absurditetin e kohës janë pesë institucione duke përfshirë Manastirin e Deçanit e që Komuna e Deçanit nuk është

njëra nga to. Gjatë ditës së djeshme kompania e cila po i kryen punimet jashtë zonës së veçante, ka hequr nga rruga brenda zonës së veçante gurët nga rrëshqitja e dheut të cilat kanë ndodhë si pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve në zonën e veçante më pëlqimin e Manastirit që sipas Ligjit është aktivitet strikt i ndaluar. Rrëshqitjet dhe gurët janë larguar më qellim që kjo rrugë të jetë e kalueshme dhe e sigurt për kompaninë dhe qytetarët e shumtë që kalojnë përgjatë kësaj rruge. Ky aktivitet human dhe i domosdoshëm po del që personeli i Manastirit ka pritur një rast për të bere mashtrimin e radhës. Objektivat e ndërtimit të kësaj rruge janë: paqësore, në harmoni me qëllimin e Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, në përputhje me kuadrin vizual dhe estetik të zonës, në harmoni me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, arkitektonike dhe në funksion të ruajtjes dhe të promovimit të trashëgimisë natyrore. Ky aktivitet i renovimit-asfaltimit të rrugës ekzistuese është zhvillim i favorshëm për të gjitha komunitetet.

Në qytetarët e Deçanit edhe sot edhe në kohë të më hershme kemi bashkëjetuar duke respektuar mo-

zaikun e trashëgimisë kulturore fetare gjë e cila nuk ka ndodhur në të gjitha periudhat historike nga Manastiri kundrejt qytetarëve shqiptar të Deçanit. Koncepti i vetëm i cili udhëheqë qytetarët e komunës së Deçanit është koncept zhvillimor dhe i shfrytëzimit të potencialeve dhe resurseve, qasjes më të letë ne to për të pasur një standard më të mirë për jetën dhe për familjet tona. Ky është dhe do të jetë qëllimi ynë i vetëm pa mashtruar të tjerët.

Në këtë rast personeli i Manastirit bën mirë të jetë së bashku me konceptin tonë dhe ti lër anash qëllimet dashakeqëse kundrejt 70 mijë qytetareve të komunës së Deçanit. Sa i përket pronave të dhuruara nga shteti gjenocidal serb i udhëhequr nga Sllobodan Millosheviq në vitin 1994-1997 e të cilat ju dhanë edhe me vendimin te gjykatës Kushtetuese të Republikë së Kosovës, vlerësojmë se Manastiri i Deçanit është dashur këtë pronë ta kërkoj vetëm nga qytetarët e Komunës së Deçanit. Për një jemi të sigurt se qytetarët e Komunës së Deçanit as një herë nuk janë udhëhequr nga idetë shoviniste dhe të nxitjes së luftërave kjo është e dëshmuar sot e gjithë ditën", thuhet në reagimin e Komunës së Deçanit.



Qeveria e Serbisë: Nuk duam luftë të re me Kosovën

Qeveria e Serbisë i ka dhënë mbështetje presidentit Aleksandar Vuçiq, pas deklaratës së kreut të shtetit se do të luftojë kundër mbajtjes së konfliktit të ngrirë me Kosovën, sepse nuk dëshiron luftëra të reja.

Serbia duhet të bëjë gjithçka për të parandaluar konflikte të reja me autoritetet e Prishtinës dhe presidenti Aleksandar Vuçiq e ka mbështetjen e ministrave të Qeverisë së Serbisë, sepse, siç thonë ata, tash më së paku ju duhen konfliktet dhe një luftë për Kosovën, raporton gazeta serbe "Kurir".

Presidenti serb më parë ka thënë se do të bëjë çmos për të luftuar ndaj qëndrimit të 80 për qind të popullatës, që mendojnë se Serbia duhet ta mbajë konfliktin e ngrirë.

"Sepse, një ditë kur të shkrihet [konflikti], nuk dua të jem përgjegjës për një luftë të re dhe nuk dua që kjo të ndodhë në Serbi. Nuk do të marrë një vendim kundër popullit tonë, por do të përpiqem për të bindur shumicën se paqja dhe stabiliteti janë më të rëndësishme se çdo gjë tjetër", tha Vuçiq. Ministri i Jashtëm Ivica Dačić thotë se konfliktet e hapura janë diçka që më së paku i duhet Serbisë, por nuk do të pajtohen me poshtërim.

"Të gjitha përpjekjet e udhëheqjes shtetërore tregojnë se Serbia është e vendosur të kapërcejë konfliktin e ngrirë. Vuçiq ka të drejtë kur thotë se kjo nuk do të jetë aspak e lehtë, por kjo nuk do të thotë se është e pamundur. Nuk duam të rrezikojmë konfliktet në rajon. Megjithatë, edhe zotërinjtë në Bruksel duhet të dinë se ne nuk jemi fëmijë, të cilëve do t'u japin një sheqerkë, për shkak se na kanë thënë 'do të anëtarësoheni në BE' dhe pastaj ne të harrojmë Kosovën", tha Dačić.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjurijq beson se në kushtet komplekse gjeopolitike, Serbia duhet të gjejë mënyrën më të mirë për të siguruar mbijetesën dhe përparimin e saj, shkruan telegrafi. "Kemi nevojë për një zgjidhje të përhershme për çështje të hapura në rajon, në mënyrë që të krijojmë kushte për zhvillim demokratik dhe ekonomik. Kjo është arsyeja pse konflikti i ngrirë nuk është një opsion. Fjala kyçe në gjithë këtë është kompromisi", tha ai.

Tri vjet nga varrimi i të vrrarëve në Kumanovë

Mijëra qytetarë nga mbarë vendi, por edhe nga troje të tjera shqiptare, para tri viteve, u kanë dhënë lamtumirën e fundit të prej nëntë kosovarëve të vrrarë në Kumanovë të Maqedonisë.

Pas homazheve dhe një akademie përkujtimore, djem me uniforma të UÇK-së kanë përcjellë për në banesën e fundit, në kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve, në Prishtinë, trupat e Xhafer Zymberit, Mirsad Ndrecajt, Valon Kabashit, Turgaj Gashit, Samid Kastriotit, Hysen Rushitit, Fatlum Vishesellës dhe Arben Rexhajit.

Nga Këshilli Organizativ, në përbërje të shoqatave të dala nga lufta, familjarëve e personaliteteve të tjera, të rënë në Kumanovë gjatë një konflikti me policinë maqedonase më 9 dhe 10 maj, janë



nderuar si dëshmorë. Përveç disa deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje e të AAK-së, askush nga institucionet e larta të shtetit nuk ka qenë as për homazhe e as në varrimin e organizuar në kryeqytet.

Teksa varrimi është mbajtur në orën 17.00 në praninë e mijëra qytetarëve nga tërë Kosova, para-

shur me uniformën e dikurshme të UÇK-së qëndronin pranë arkivele.

Në duar ata mbanin fotografi të të vrrarëve në Kumanovë, fotografi këto të montuara, sipas të cilave këta të fundit paraqiteshin të kenë qenë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në fakt, disa prej tyre kanë qenë në UÇK, kanë qenë pjesë edhe e UÇPMB-së në Luginë të Preshevës, por në vitin 2001 edhe pjesë e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni.

Ndërkohë, në qendrën e parburgimit në Shutkë të Shkupit po mbahen nëntëmbëdhjetë kosovarë, të cilët janë arrestuar gjatë aksionit të policisë maqedonase në "Lagjen e Trimave" në Kumanovë./Perokopi

TATËPJETAT E EKONOMISË RUSE

Shumë sipërmarrje gjermane e konsideronin tregun rus deri para disa vitesh si një prej tregjeve më të suksesshme. Por sektori i financave në Rusi i ka punët keq dhe në këtë mënyrë janë dëmtuar investoret, prodhuesit dhe tregtarët. Të gjithë ata kanë shpresuar vazhdimin e bumit ekonomik. Prej 24-26 maj në Rusi mbahet Forumi Ekonomik Ndërkombëtar (SPIEF), ku po marrin pjesë ekspertë dhe politikanë nga më shumë se 100 vende të ndryshme, ndër ta edhe nga Gjermania.

Pas 12 vitesh punë në Rusi, MediaMarkt ka vendosur të tërhiqet nga ky vend. Tregtuesi më i madh me pajisje elektrike është i përfaqësuar në 14 vende të ndryshme të Evropës. Ceconomy AG, e cila e mbanë këtë rrjet të dyqaneve në Rusi, tani po përpriqet t'ia shes ate konkurrentit rus "M.Video".

MediaMarkt ka mbyllur në muajt e fundit gjashtë filiala në Rusi, gati çdo të 10-tën. Kështu thuhet në raportin vjetor të kësaj sipërmarrje. Si shkak për tërheqje është dobësimi i Rublës ruse dhe rënia e përfitimeve në Rusi. Për shkak të sanksioneve amerikane ndaj Ruisë, të vendosura në prill, mendohet se Rusia nuk do të ketë këtë vit rritje ekonomike.



OTTO DHE QUELLE MBYLLIN ONLINE-SHOPS

Gjiganti tregtar gjerman Otto Group do të largohet pjesërisht nga Rusia. Në prill koncerni ka bërë të ditur se këtë verë do t'i mbyllë dy online-shops: "otto.ru" dhe "quelle.ru", që në Rusi veprojnë prej më shumë se 10 vjetësh. Otto Group kumtoi se mbyllja e këtyre dyqaneve online ka të bëjë me ndryshimet strategjike të koncernit. Një rol të rëndësishëm këtu luan edhe konkurrenca e shtuar ruse në tregun online. Ekspertët thonë se mbyllja e Online-Shops ka të bëjë megjithatë me dobësimin e Rublës dhe rritjen e çmimeve të prodhimeve gjermane në treg.

Otto Group ka probleme edhe me "bonprix.ru" dhe shitësin e tekstilit "Witt", por ka vendosur që këto të mos i mbyllë. Punën do ta vazhdojë edhe "eSolutions" – sek-

tori i shitjeve të logjistikës, marketingut dhe shërbimeve të IT.

RUSIA NUK ËSHTË MË PRIORITET I ADIDASIT

Prodhuesi gjerman i pajisjeve sportive Adidas do ta reduktojë prezencën e vet në Rusi, varësisht nga zhvillimet në treg. Vendimi është marrë në vitin 2014, kur është regjistruar rënia e parë serioze e kursit të rublës. Pritjet e koncernit janë pesimiste. Adidas-i e kishte shpallur Rusinë dhe vendet ish-sovjetike si prioritet në fillim të kësaj dekade – krahas Amerikës Latine dhe Kinës. Për një kohë të gjatë Adidas-i ka shënuar atje fitime të mëdha, deri në 10% në vit. Por fitimi tani ka rënë në vetëm 3% dhe si pasojë vitin e kaluar janë mbyllur shumë dyqane. Në këtë rajon kanë mbetur edhe rreth 600 dyqane,

ndërkohë që para disa vitesh kanë qenë 1.200.

METRO AG DO TË BËJË NDRYSHIME

Metro AG u kthehet tregjeve Cash & Carry. Kjo sipërmarrje ka atje rreth 89 përfaqësi në 50 rajone të ndryshme të Ruisë por edhe në Krimenë e anektuar. Koncerni është aktiv në 25 vende të ndryshme dhe nuk përjashton madje që të shtohet numri i përfaqësive.

Në këtë rajon është investuar kaq shumë para sa që Metro AG nuk mund t'i lejojë vetes tërheqjen. Koncerni ka paraqitur në maj një plan për ndryshime të punëve në Rusi. Ai do të punojë në të ardhmen edhe me restorante, kafene dhe dyqane të vogla. Por edhe në fushën e Cash & Carry është shtuar dukshëm konkurrenca në Rusi./ DW



Front i bashkuar Macron-Putin

Presidenti rus Vladimir Putin dhe homologu i tij francez Emmanuel Macron duket se kanë gjetur një kauzë të përbashkët në shqetësimin ndaj veprimeve të presidentit amerikan Donald Trump mbi Iranin, ndryshimet klimaterike dhe tregtinë ndërkombëtare.

Franca është në kundërshtim me Kremlinin mbi aneksimin e Krimës nga Ukraina, ndërsa ekzistojnë pretendime se Moskë është përfshirë në zgjedhjet presidenciale franceze në mbështetje të një prej kundërshtarëve të Macron. Por kur presidenti francez u takua me homologun Putin në Forumin Ndërkombëtar Ekonomik të Shën Peterburgut, nuk pati shenja të këtyre problemeve mes palëve.

Dy liderët u përqëndruan tek e ardhmja shqetësuese e marrëveshjes shumëkombëshe mbi programin bërthamor të Iranit, që tashmë është në rrezik pas tërheqjes së Shteteve të Bashkuara.

Në sesionin e pyetje-përgjigjive, presidenti Putin e cilësoi këtë vendim si dëmtues dhe jo-produktiv, ndërsa i kërkoi Shteteve të Bashkuara të mos zbatojnë ligjet e tyre përtej kufinjve.

Macron ndërkaq, i cili u takua me presidentin Trump për ta bindur t'i besonte marrëveshjes së Iranit, nuk kritikoi haptazi liderin amerikan. Gjithsesi Macron pranoi se ka çështje për të cilat palët kanë ndasi, ndërsa theksoi se do të përpriqej ta bindte Trump t'i rikthehej diskutimeve jo vetëm për marrëveshjen e Iranit, por edhe për vendimin e zhvendosjes së ambasadës amerikane nga Tel Avivi në Jeruzalem, jashtë dakordësisë me shumicën e qeverive europiane.

Erdogan u bën thirrje turqve: Ktheni eurot e dollarët në lira

Presidenti turk, Tayyip Erdogan, i bëri thirrje shtetasve turq të shtunën që të konvertojnë kursimet e tyre dollarë apo euro në lira, duke kërkuar të forcojë monedhën që është në vështirësi, e cila ka humbur 20 për qind të vlerës së saj ndaj monedhës amerikane.

"Vëllezërit e mi që kanë dollarë ose euro nën "jastëkun" e tyre. Shkoni dhe i konvertoni paratë tuaja në lira", tha Erdogan në një tubim në qytetin lindor të Erzurumit përpara zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të 24 qershorit.



Turqia u drejtohet këtyre

zgjedhjeve duke u ballafaquar me një kolaps të monedhës së tij që kërcënon të shkaktojë një krizë ekonomike.

Që nga fillimi i vitit, lira turke ka humbur gati 20% të vlerës kundrejt dollarit amerikan, edhe pse arriti ta merrte veten disi këtë javë pas një rritjeje të normës së interesit nga Banka Qendrore Turke.

Ka shenja gjithnjë e më të mëdha se qeveria e Erdoganit po shtrëngon kontrollin e saj jo vetëm mbi Turqinë, por edhe mbi Bankën Qendrore që po kthehet në fokusin e saj, thotë ekonomisti financiar botëror i Commerzbank, Peter Dixon.

LIDERETË KOREANË TAKOHEN PËR TË BISEDUAR PËR AMERIKËN

Udhëheqësi koreano-verior, Kim Jong-un rikonfirmoi angazhimin e tij për të "përmbyshur" denuklearizimin e gadishullit Korean, si dhe për takimin e planifikuar me presidentin amerikan Donald Trump.

Të paktën kështu shprehet presidenti koreano-jugor, Moon Jae-in. Në Uashington, presidenti amerikan Trump la të kuptohej se përgatitjet për samitin e 12 qershorit me Kim Jong-unin ishin duke vijuar rregullisht, pavarësisht se ai

anuloi takimin gjatë javës së fundit.

Moon dhe Kim ranë dakord gjatë një takimi të papritur të mbajtur gjatë së shtunës se, samiti i mundshëm mes Koresë së Veriut dhe Amerikës duhet zhvilluar.

"Udhëheqësi Kim dhe unë kemi rënë dakord që samiti i 12 qershorit duhet zhvilluar dhe duhet të jetë i suksesshëm, ndërsa objektivi ynë për denuklearizimin e gadishullit Korean dhe për një regjim paqësor nuk duhet ndalur",



tha Moon gjatë një konference për shtyp në Seul.

Takimi ishte i fundit i një serie kthesash dramatike diplomatike

përgjatë kësaj jave, mbi perspektivën e samitit të pazakontë mes një presidenti në detyrë të Amerikës me një udhëheqës koreano-verior, si dhe sinjali më i fortë deri më tani se dy udhëheqësit koreanë po përpriqen ta mbajnë takimin sërish mbi shinat e duhura.

Një deklaratë e agjencisë koreano-veriore të lajmeve "KCNA" bënte të ditur se Kim kishte shprehur "vullnetin e tij të palëkundur" mbi takimin e mundshëm me Trumpin siç ka qenë planifikuar.

70 VJETORI I GJENERATËS SË PARË TË SHKOLLËS "LIRIA"

SHKUPI DHE SHKOLLIMI SHQIP



Nga Naxhi NDOCI

Ditë e kthjellët e 13 nëntorit. Jehonte brohoria ngazëlluese e qytetarëve se erdhi dita e lirisë. Të dalë nëpër rrugë, zgjatëshin duar, shtrëngoheshin të përcjellura me buzëqeshje të sinqerta. Nuk u prit shumë. Filluan veprimtaritë shoqërore, kulturore e posaçërisht arsimore.

Ata pak intelektualë shqiptarë ëndëronin për hapjen e shkollës në gjuhën amtare. Në këtë drejtim pa pushuar veprimtarinë edhe arsimdashësi i mash, Azem Marana, i cili sapo kishte mbaruar shkollën normale "Sami Frashëri" në Prishtinë. Me të dëgjuar ardhjen e Hasan Billallit në Shkup, filluan intenzivisht punën rreth hapjes së shkollës fillore në gjuhën shqipe në Shkup. Pas shumë përpjekjeve të bëra në organet shtetërore e të qytetit të Shkupit arritën qëllimin e më 1 dhjetor të vitit 1944 filloi nga puna shkolla fillore e emërtuar "Liria" në oborrin e xhamisë "Jahja pasha", godinë kjo e vjetër e fillores "Vuk Karaxhiq".

ORA E PARË E MËSIMIT SHQIP

Gjatë okupimit bullgar, që në vitin 1941 u hap medreseja "Alije" në oborrin e xhamisë "Isa beg", shkollë kjo fetare po edhe me lëndë të një shkollimi laik. Tri klasat e para në këtë medrese më avancuan regjistrimin në lasën e katërt të shkollës "Liria".

Ora e parë pritej me kërsëri nga të gjithë ne, të cilët që më parë kishim mësuar në shkollat fetare e në gjuhën turqishte. Në klasë hyri zoti Azem Marana. Na vështroni me dashuri të madhe, buzëqeshi e foli "Fëmijë të dashur, unë mësuesi i juaj i parë. Quhem Azem Marana, nga fshati i Shkupit, Marana. Jam drejtor i shkollës dhe kujdestar i klasës së katërt. Ndiej nevojën t'i them disa fjalë që kanë të bëjnë për zhvillimin dhe përparimin e kombit tonë në arsim. Me shekuj kemi qenë të nënshtruar regjimeve të ndryshme e s'kemi patur mundësinë të shkollohemi në gjuhën tonë të bukur shqipe. Erdhi koha që edhe ne të arsimohemi. Ju, nxënës të dashur keni për detyrë të mësoni se vetëm me shkollim do të ecim përpara".

Këto fjalë të mësuesit të parë Azem Marana, na erdhën aq ëmbël sa sot e kësaj dite nuk më harrohen. Ishin këto fjalë melhem

Më 7 shkurt të vitit 1947, kur u shqiptuan dënimet e rënda për të gjithë (me vdekje - pushkatim u dënuan Azem Marana, kapiten Hysni Rudi, Mehmet Bushi dhe Qemal Skenderi kurse të pesëmbëdhjetët të tjerë u dënuan me burgim prej 2 deri më 20 vjet), në korridorin e krijuar, në reshtin e parë u gjetëm edhe ne. Kur Azem Marana, në përcjellje të dy milicionerëve, na pa, përsëri e ngadalësoi hapin, i zbehur në fytyrë, buzëqeshi dhembshëm e na tha: "Vazhdoni me shkollimin"



për shpirtin tonë. Na ngrohën zemrën. Na dhanë vullnet të pasqor për të mësuar sa më tepër. Me të përfunduar klasën e katërt, vijam më tej në vitin e parë të gjysmëmaturës. Vitin e parë e vijam në një shkollë të vjetër tregtare që gjendej përtej Urës së Gurit, mu në vendin ku sot gjendet Qendra tregtare. Vitin e dytë dhe të tretë e vazhduam në godinën e madhe të gjimnazit femëror "Josip Broz Tito" afër lumit Vardar, ku sot është godina e Qeverisë së Maqedonisë, që u ndërtua pas tërmetit katastrofal, mu në oborrin e këtij gjimnazi.

Tri vitet e progimnazit kaluan në kushte jo edhe aq të mira ngase na mungonin libra adekuate. Çdo lëndë diktohej nga profesorët. Shërbeheshim edhe me disa libra të botuara në Shqipëri gjatë kohës së okupimit Italian. Sido që të jetë, mësimi zhvillohej me dashuri të madhe nga të gjithë ne ngase profesorët i kishim shumë të aftë. Këtu do të përmendi punën e palodhur të këtyre profesorëve, të cilët kishin një barë të rëndë të na edukojnë në frymën e shkollimit standard evropian. Profetori Koço Floka, Korçar nga Shqipëria, zhvillonte lëndën e matematikës dhe të fizikës me metoda e shpjegime konkrete sepse atëbotë nuk disponohej me kurrfarë kabineti shkollior. Profetori Remzi Prapaniku ishte gjuhtar i sprovuar në arsim, gjegjësisht në zbrërthimin e të gjitha modaliteteve morfologjike e gramatikore të fjalës. Përveç gramatikës shqipe, mbante mësim

edhe në letërsinë shqipe e begatur nga shumë autorë si nga më të vjetrit ashtu edhe të atyre nga koha e Rilindjes kombëtare. Shpjegimet e tija përplot nyansime të skeprtit të gjerë letrar na lartësonin në hapësirat më të thella të gjinisë artistike letrare. Sa për mua, i gëlltita çdo fjalë të tij, çdo shpjegim që kishte të bënte me letërsinë. Mund të them se në atë moshë të re që isha, lexova një numër të mirë të veprave të autorëve shqiptarë e që të gjitha këta më lanë mbresa të pashlyera dhe që këto u shndërruan në dashuri të madhe për lexim. Profesoresha Olivera Jashari, zhvillonte lëndën e gjeografisë dhe atë të gjuhës maqedonase. Prej saj thithëm njohuri për shumë kuptime gjeografike ngase dispononte me aftësi të jashtëzakonshme të bindjes. Profetori Abdulla Sylejmani me një ton tejet të këndshëm na fliste për ngjarje historike, për të kaluarën tonë të lashtë, për fiset ilire që zotëronin siudheshën ballkanike, për pushtimet e mëdha të Lekës së Madh, i cili nga origjina e tij ishte ilir si nga ana e gjyshes së tij, Euridika, nëna e Filipit të dytë, që ishte nga fisi ilir Linkestis, kurse e ëma, Olimpia, gruaja e Filipit të Dytë, ishte bijë e Neoptolemit të Parë, mbret i njohur i Epirit ilir. Njohuritë nga e kaluara historike të të parëve tanë ishin jashtë programit të hartuar të lëndës së historisë, por ai fliste për to me emocion e krenari, që këto ndjenja i mbollti thellë në shpirtin tonë. Më kujtohet mirë, se rrugës

për të kthyer në shtëpi në orët e para të errësirës së muajve dimërore, bisedonim me shokët, i komentonim po kështu më krenari e qe besa edhe në do raste mbureshim me to. Kthimi përmes Urës së Druarit, duke i ngjitur përpjetëzës së Kalasë e tatëpjetë për në lagjen tonë Mëhalla e Thatë, kalonte shpejtë. E kur arrija në shtëpi, ende nën ndikimin e mësimin të marrë nga profesori i historisë, ia tregoja babait, vëllait e të shoqes, të cilët më përcillnin me sy të qepur e pazë. Lëndën e gjuhës ruse na e mbante profesori Qurçiev. Singërisht të them, këtë mësim nuk e çmonim shumë, por e mësonim e tregonim sukses ngase ishte gjuhë sllave e ngjashëm me maqedonishten. Lëndën e vizatimit, (të artit të pikturës) njëherë në javë e mbante profesori Abdulla Sulejmani, kurse lëndën e fizikurës një profesor maqedonas i gjimnazit femëror.

FUNDI I SEMIMATURËS

Vitin e parë e përfundova me sukses të shkëlqyeshëm. Me sukses të shkëlqyeshëm përfunduan edhe disa shokë të mi. Edhe të tjerët në klasë, e ishim nëntëmbëdhjetë, e dolën me sukses të mirë kështu që pas pushimeve verore të gjithë do ta vazhdonim vitin e dytë të progimnazit. Por gjatë pushimeve u përhap lajmi se disa arsimtarë me në krye Azem Maranën janë burgosur për aktivitetin e tyre, siç thuhej anti-popullor, pra kundër shtetit. Bur-

gosja e tyre na pezmatoi pa masë sepse pak gjë dinim për veprimtarinë e partisë Nacional Demokratit Shqiptar. Çdo gjë flitej. Lajmet shpesh ishin kontradiktore. Burgosja e Azem Maranës na pezmatoi shumë. Ne që ishim nxënësit e tij nuk u besonim fjalëve të rënda që na arrinin nga ata që ishin bindur pushtetit e sidomos nga bashkëqytetarët maqedonas. Jam i bindur se në shumë familje shqiptare në Shkup e në të gjitha trojet shqiptare është biseduar e diskutuar për situatën e krijuar me burgosjen e arsimtarëve pishtar siç ishin Azem Marana, Hasan Billallit, Mamut Dumani, Qemal Skenderi, Jonuz Bella, Kapiten Hyseni Rudi, Mehmet Bushi dhe shumë të tjerë në qytetet shqiptare. Burgosja e tyre pati jehonë të madhe edhe jashtë republikës sonë po edhe në botë. 26 korriku i vitit 1946 ishte pikëlluese për të gjithë ne.

Fillimi i vitit të dytë të semimaturës na solli edhe ndërrimin e shkollës. Nga shkolla tregtare, na vendosën në katin e tretë të gjimnazit femëror "Josip Broz Tito" rreth Vardarit. Vendosja në këtë godinë ishte më i përshtatshëm për ne sepse e konsideronim vetën shkolllarë të vërtetë në një shkollë që gumzhonte gjatë mbajtjes së mësimin si në turnin e paradites ashtu edhe në atë të pasdites. Mund të them se mësonim me zell, por gjithnjë ishim të ngarkuar me faktin se arsimtarët tanë pishtarë gjenden pas grilave.

Përmes shtypit dhe radios u

lajmërua se gjykimi i të nëntëmbëdhjetë të akuzuarve të burgosur të NDSH-së do të fillonte me 30 janar e do të mbahet në shtëpinë e postës (Poshtanski dom) që gjendej pak më larg nga gjimnazi femëror. Që nga fillimi i gjykimit, pas orëve të paraditës, unë me disa shokë (Amir Gashi, Refik Selimi, Nazmi Kajtazi) përveç të shtunës dhe të dielës, shkoni për ta përcjellur gjykimin. Në oborrin e godinës ku mbahej gjykimi gjenim përplot qytetar, që asistoni në këtë gjykim publik, por që brenda në sallë të madhe nuk kishte vend për ta. Dy ditëve të fundit arritëm të afrohem kordonit të njerëzve që pritnin për ti parë të burgosurit. Qëndronim në reshtin e parë kur në përcjellje të milicëve dolën të burgosurit me krye me Azem Moranën për të transmetuar në burg. Me të afuar zoti Azem Marana na diktoi. Na shikoi me plot dashuri dhe na belbëzoi qartë, tha: "Mësoni". Milicioneri pranë tij ia shtrëngoi krahun dhe e shtyri të heqë më shpejt.

Një ditë më vonë, më 7 shkurt të vitit 1947, kur u shqiptuan dënimet e rënda për të gjithë (me vdekje - pushkatim u dënuan Azem Marana, kapiten Hysni Rudi, Mehmet Bushi dhe Qemal Skenderi kurse të pesëmbëdhjetë të tjerë u dënuan me burgim prej 2 deri më 20 vjet), në korridorin e krijuar, në reshtin e parë u gjetëm edhe ne. Kur Azem Marana, në përcjellje të dy milicionerëve, na pa, përsëri e ngadalësoi hapin, i zbehur në fytyrë, buzëqeshi dhembshëm e na tha: "Vazhdoni me shkollimin". Fjalët e tij na u ngulën si thika në zemër. Këto fjalë - emanet të tij kurrë së kurrës s'do t'i harroj. Qemal Skenderit nga gjyqi suprem i Beogradit, me urdhrin e Komitetit qendror të partisë, dënimi me vdekje iu shndërrua në burgim të rëndë 20 vjeçar, kurse të tre të tjerët u pushkatuan. Sot e kësaj dite nuk i dihet varri i Azem Maranës.

U varguan muajt e vitit rrjedhës. Në mësimet kaloi edhe viti i tretë e arriti 25 maji i vitit 1948. Atë ditë maji, e martë, në orën e letërsisë, kur profesori Remzi Prapaniku na fliste për romanin e njohur të Sami Frashërit, "Dashuria e Talatit me Fitneten", në klasë hyri profesor Koço Floka, i skuqur në fytyrë. Kërkoj nga profesori Remzi leje për një informim të shkurtër. Na u drejtua duke na shikuar të gjithëve me rend, tha:

- Nxënës, thoni baballarëve, nesër pasdite, këtu, të vinë në mbledhje prindërore. Mos të mungojnë se do të kemi një bisedë me rëndësi. Kaq.

Doli nga klasa me hap të shpejtuar. Ne u shikuam në mes veti. Profesori na tërhoqi vëmendjen dhe vazhdoi me sqarimin mbi romanin. Ftesën e bërë nga kujdestari i klasës ia thash babait. Ai, të nesërmen në kohë të caktuar vajti në gjimnaz në mbledhjen prindërore. Pasditja më kaloi në pritje e hamendje se vallë çfarë është di-



• Drejtori i shkollës LIRIA, Azem Marana me nxënësit e klasës 4

skutuar në atë mbledhje. Pasi drekuam, iu drejtova babait të na tregojë se çfarë u tha krejt në atë mbledhje prindërore. Ai, pasi tymosi kamishin, tha:

- Kujdestari i klasës, Koço Floka na informoi se qëndrimi i pushtetit qenka që me progjimazin të marrë fund shkollimi i nxënësve shqiptarë. Për këtë, ai është i mendimit që një delegacion prindërisht të drejtohen sekretarit republikan për sqarim. Në mbledhje u bë fjalë se cili prej nesh të caktohet në atë delegacion. Pas shumë mendimeve të shtruara erdhën në përfundim që delegacionin të udhëheqë Koço Floka, por pasi ai nuk zotëronte me maqedonishten, në grup të jetë profesoresha Olivera Jashari, kurse prej prindërve më caktuan mua - tregtar në Çarshinë e Shkupit, z. Memedali Cjilanasin si nëpunës dhe Halil Sadikun - qy-lahçiun si mjeshtër - zanatli. Nesër është paraparë vizita jonë në Sekretarijat republikan për arsim.

Me padurim pritja kthimin e babait nga ajo mbledhje, që u mbajt pasdite. Në mbrëmje në vizitë na erdhi Daja Shaban. U prit me mirëseardhje. Shakatë që i bënte ai me vëllain Metën e me fëmijët, ishin aq mirëpritëse sa gati të gjithë qesheshin shpotive të bëra. Nuk vonoi e babai u kthy nga

mbledhja. Përshëndetja me Dajën ishte miqësore. Para se të shtrohet ngrënja e darkës, pyetjes së Dajës Shaban, babai u shfry e tha:

- Çfarë të them or Shaban? Pasi jemi në dorën e tyre, bëjnë si të dëshirojnë.

- He, Shaip, si u ndatë, hë?

- Ashtu si kanë vendosur atë.

- Pa na thuaj de, - kërceu vëllai.

- Fjalën në fillim e mori profesori Koço Floka, duke e përkthyer në maqedonishte profesoresha Olivera Jashari. E ai tha se kombi shqiptar ka nevojë të madhe për shkollimin e mëtejshme të fëmijëve, se vetëm kështu do të mund të ecim krahas popujve të tjerë të emancipuar, e kështu me radhë. Sekretari e dëgjoi heshtur. Pasi ai përfundoi fjalën, na u drejtua duke na vështruar një nga një. Tha:

- Qëndrimi i tashëm është se me semimaturën përfundon shkollimi. Kaq mund të them se ndoshta në të ardhmen mund të ndryshojë çështja.

Përgjigjen e tij nuk e pëlqyem. Memedaliu u lëkund në vend, na shikoi neve e me buzë të dridhur tha:

- Nuk e kuptoj këtë qëndrim. Kjo do të thotë se ne fëmijët ti lëshojmë sokakat, hë? Pse luftuam, shoku sekretar, hë?

- Ju thash se ndoshta në të

ardhmen ndryshon ky qëndrim - tha sekretari dhe e fërkoj ballin. Na shikoi e tha:

- Kështu është qëndrimi nga Beogradi.

Seç mu dha e u bashkëngjita bisedës, thash:

- Shoku sekretar, me leje të ju pyes: Po nëse Beograd bie dakord me këtë kërkesë që do t'ia drejtoni si Sekretariat, çfarë qëndrimi do të merret?

Më shikoi pak vëngër. I çoi vullat e mu drejtua:

- Ju, cili ishit?

- Shaip Ndoci, tregtar në Çarshi të Shkupit.

- Pyetja juaj ka të bëjë me konsultime të gjatë? Po edhe nëse Beogradi merr qëndrim që duhet hapur gjimnazin e plotë, ne si Republikë jemi i një mendimi tjetër. Kjo çështje është diskutuar në Komitetin qendror të Partisë ku është marrë vendimi se me kaq përfundon shkollimi. Për më tutje s'kam çfarë të them.

- Megjithatë nëse diç ndryshon në këtë drejtim, çka bëhet? - pyeta

- Ju informojmë. Sa për tani mund t'i regjistroni fëmijët në gjimnazin mashkullor në maqedonishte. Kaq. Ju faleminderit për vizitën.

Desha të them edhe diçka nga mllefi që mu grumbullua në

krahor, por Koço Floka më kapi për krahu në shenjë të heshti. Kështu dolëm pa kryer punë.

Gati një muaj më parë ishim të informuar që qëndrimi i tashëm është se nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm nuk do t'i përvishen provimit të gjysmëmaturës. Pas një jave, sa kishin mbetur ditë për fundin e vitit shkollor, profesori Koço Floka në orën e kujdestarisë na informoi se viti përfundon me tre nxënës të shkëlqyer që do të lirohen nga provimet e gjysmëmaturës e 16 të tjerë do t'i shtrohen provimit. Me sukses të shkëlqyer dolën unë, Amir Gashi dhe Refik Selimi.

Në sekretariat për arsim u informuam se ka nevojë për kadro medicinale edhe atë për teknikë të rëntgenit. Shkollë e tillë mesatare medicinale paska në Zagreb. Unë dhe shoku im i ngushtë, Shaipi u pajtuam të vemë në Zagreb. Edhe i shtruam dokumentet për atë shkollë. Djali i xhaxhait të Shaipit, Nevzat Gjinaj studionte medicinën në Zagreb. Ai ishte informuar shpejt e lajmëron me telefon se kursesi nuk paskësh vend në konviktin gjegjës. Vajtja jonë në Zagreb u pezullua.

Gjenerata e parë e semimaturantëve shqiptarë prej 19 nxënësish përfundoi shkollimin në gjuhën e vet amtare pa patur mundësinë të vazhdojnë më lartë. Në fotografinë e vetme që e kam me shokët e klasës në progjimnaz në gjuhën shqipe janë: Muamer Limani, Nazmi Kajtazi, Amir Gashi, Qenan Alishani, profesori (kujdestar i klasës) Koço Floka, Ramiz Hasani, Zeke-rija Ramadani, Viktor Kajtazi, Viktor Mihilli (në këmbë), Marsel Kajtazi, Aziz Ramadani, Refik Selimi, Behixhe Nazifi, Kimete Sadiku, Nehal Haliti, Remzi Çoku, Medi Ibrahim, Naxhi Ndoci (të gjunjëzuar), Vullnet Starova dhe Shaip Gjinaj (të shtrirë). Prej shokëve të klasës me hapjen e rrugës për shpërngulje në Turqi, tetë u shpërngulën atje, një u shpërngul për në Francë, një në Australi, kurse nëntë prej nesh ngelën në vendlindje. Gjashtë prej nesh u regjistruam në gjimnazin "Cvetan Dimov" në gjuhën maqedonase, (unë, Shaip Gjinaj, Refik Selimi, Amir Gashi, vëllezërit Viktor dhe Marsel Kajtazi. Në shkollën e mesme të medicinës u regjistrua Vullnet Starova. Në normalen e mëvonshme mësimet i vijuan Kimete Sadiku dhe Nehal Haliti). Disa prej nesh iu përmbajtëm amanetit të Azem Maranës. Vazhduam shkollimin e lartë. Vullnet Starova diplomoi medicinën dhe fitoi shumë poste në lëminë gjegjës e më vonë u emërua për kryetar të Kuvendit republikan në mandatin katër vjeçar (prill 1986 - janar 1991), unë vijova në Albanologji e iu kushtova gazetarisë e më vonë shkruam letrar, Kimete Sadiku u bë profesore dhe gjuhës dhe letërsisë shqipe, Amir Gashi iu kushtua juridikes si dhe Marsel Kajtazi në juridik, kurse i vëllai Viktor Kajtazi në ekonomi.



• Nxënësit e progjimnazit LIRIA me profesor Koço Floka



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 60/2018

për punësimin e 16 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Ndërmarrja publike e Rrugëve Shtetërore “për vendet e punës në vijim:

1. KDR0102V01075 Këshilltar për investime dhe ndërtimin e rrugëve me mjete të RM, Njësia për investime dhe ndërtimin e rrugëve me mjete të RM, Sektori për investime me mjete nga RM

2 realizues(ë)

- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivei i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit (inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi rrugë dhe hekurudhë, drejtimi nga hidroteknika, gjeoteknika ose drejtimi konstruktiv)
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30
- Rroga neto: 36.140,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 2.

2. KDR0102V01075 Këshilltar për investime dhe ndërtimin e rrugëve me mjete të FNI, Njësia për investime dhe ndërtimin e rrugëve me mjete të FNI, Sektori për investime me mjete nga FNI

6 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivei i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30
- Rroga neto: 36.140,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 2.

5. KDR0102B04045 Udhëheqës i njësive për mbrojtje të ambientit jetësor dhe aspektet sociale, Sektori për investime me mjete nga FNI

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivei i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Ambienti jetësor
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

3. KDR0102V01076 Këshilltar për përpunim dhe vëzhgimin e dokumenteve projektuese me mjete nga RM, Njësia për përgatitje teknike dhe planifikim me mjete nga RM, Sektori për investime me mjete nga RM

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30

Rroga neto: 38.012,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Rom(e) 1.

6. KDR0102V010181 Këshilltar për mbrojtje të ambientit jetësor, Njësia për mbrojtje të ambientit jetësor dhe aspektet sociale, Sektori për investime me mjete nga FNI 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivei i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Ambienti jetësor
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30

Rroga neto: 36.140,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

7. KDR0102V01075 Këshilltar për investime në pjesën për objektet elektroenergetike, Njësia për investime dhe ndërtimin e rrugëve me mjete të RM, Sektori për investime me mjete nga RM 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivei i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Elektroteknikë
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30

Rroga neto: 36.140,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

8. KDR0102B03019 Ndihmës udhëheqës i sektorit për investime me mjete nga FNI 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit, Ekonomi
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30

Rroga neto: 40.300,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

9. KDR0102B04124 Udhëheqës i njësish për RAMS - Sistemi për menaxhim me rrugët, Sektori për sigurimin e rrugëve dhe menaxhim me rrugët 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit, Makineri, Teknikë kompjuterike dhe informatikë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

- Përshkrimi i orarit të punës: me fillim të orarit të punës në mes orës 08:00 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 16:00 dhe 16:30

Rroga neto: 35.776,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

MATKA
QENDRA EKSPOZUESE

MËSO DIÇKA
TË RE!



matka.com.mk

EVN



DASHI 21. mars - 20. prill

Klima yjore do jete shume e mire gjate kesaj dite dhe do e beje jeten tuaj ne çift akoma me te bukur. Nuk do tundoheni aspak nga personat qe do i joshin sepse për ju ekziston vetëm një person: partneri qe keni ne krah. Beqaret do ritakohen me një ish te dashur dhe do e kuptojnë se ndiejnë akoma për te. Financat do jene te shkëlqyera. Përfitonit për te hequr disa para mënjane.



DEMI 21. prill - 21. maj

Çiftet do kalojnë një dite shume te mërzitshme dhe qe mezi do presin qe ajo te mbaroje. Partneri as qe do mendoje t'iu përkëdhelë apo t'iu mbaje pranë. Nëse jeni ende vetëm duhet te bëni akoma dhe me tepër durim gjate kesaj dite. Nuk është koha e duhur për te dale neper takime. Ne planin financiar do iu duhet te merrni vendime te mëdha. Do ia dilni mbanë.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nëse jeni ne një lidhje, nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni gjate kesaj dite. Partneri do iu mbaje pranë dhe do iu leshojte gjate gjithë kohës. Do ndiheni me te vërtetë te dëshiruara. Beqaret nuk do dini çfarë te bëjnë duke qene se personat qe do takojnë nuk do jene ne lartësinë e duhur. Urani do sjelle te papritura jo te këndshme ne planin financiar. Kujdes!



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Fale ndikimit te Uranit dhe te Neptunit ne jeten tuaj ne çift, do kaloni momente te animuara pranë atij qe dashuron. Disa do mendojnë shpesh sikur janë ne ëndërr. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare dhe me ne fund do ndihen te plotësuar. Ne planin financiar do përballeni me goxha vështirësi te cilat do ju marrin goxha kohe për t'u zgjidhur.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse ka kohe qe marrëdhënia ne çift po shkon me se miri, pse te mos mendoni sot për një bashkëjetesë? Te jeni te sigurt se do ndiheni edhe me mire dhe emocionet do jene te papërshkrueshme. Mos keni frike nga përgjegjësitë. Beqaret do kenë takime te rëndësishme. Ne planin financiar do mund te kryeni investime te rëndësishme qe do e përmirësojnë situatën shume shpejt.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ata qe kane pasur disa debate te forta ne çift kohet e fundit do kalojnë një dite shume te vështirë dhe me tension, ndërsa ata qe kane pasur një marrëdhënie te qete, do përjetojnë emocione pozitive. Për beqaret Venusi do jete planeti me i favorshëm dhe qe do nxite takimet interesante. Financat do jene me te mira se disa dite me pare, por shpenzimet e mëdha duhen shmangur.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Jeta juaj ne çift do jete ne qendër te vëmendjes gjate kesaj dite. Tregohuni sa me realiste qe te mundeni nëse nuk doni te përballeni me probleme. Beqaret edhe sot do e kenë te vështirë ta gjejnë personin e përshatshëm. Mos e humbni besimin, por bëni edhe pak kohe durim. Ne planin financiar nuk mund ta përmirësoni dot buxhetin pa përdorur strategji strikte.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Nen ndikimi e forte te Merkurit ju do rivendosni komunikimin dhe bashkëpunimin ne çift. Do arrini me ne fund t'i zgjidhni mosmarrëveshjet dhe do e shihni me optimizëm te ardhmen. Beqaret do kërkojnë gjera te pamundura, prandaj dëshirat nuk do mund t'iu realizohen dot. Ne sektorin financiar duhet te tregoheni me vigjilente se kurrë qe te mos keni vështirësi me pas.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Duke folur hapur me partnerin dhe duke e toleruar me tepër njeri-tjetrin do mund t'i kaloni edhe ato pengesa te vogla qe ju ishin shfaqur. Beqaret nga ana tjetër do iu kushtojnë me tepër rëndësi ndjenjave dhe do bëjnë çmos qe ta bëjnë për vete personin qe do pëlqejnë. Situata financiare do jete mjaft e trazuar. Kujdes me çdo shpenzim qe do iu duhet te kryeni.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Sot do e kuptoni me mire se personi qe keni ne krah me te vërtetë është ideal për ju. Ai do iu ndihmoje për gjithçka qe do keni nevojë dhe do ju beje te mos ndiheni kurrë vetëm. Beqaret duhet te mendohen mire pare se te bëjnë ndonjë zgjedhje. Ne planin financiar nuk do ketë surpriza te këqija, kështu qe do jeni me te qete dhe do shpenzoni pak me tepër.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dite e bekuar kjo e sotmja për te dashuruarit. Çdo gjë do shkoje ashtu si ju e kishit menduar dhe kënaqësitë do jene te papërshkrueshme. Beqaret nuk do përfitojnë aq sa duhet nga mundësitë qe do ju jepen dhe do pendohen edhe vete për këtë gjë. Ne planin financiar mos ua plotësoni qejfin veten për çdo gjë se pse keni për te ngelur pa asnjë para ne xhep.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Duhet te bëni me shume lëshime gjate kesaj dite ne jeten tuaj ne çift sepse përndryshe nuk do arrini dot te jetoni qetësisht. Edhe partneri do mundohet te toleroje me tepër. Beqaret do kenë një takim mbresëlënës kështu qe duhet ta shfrytëzojnë ditën sa te mundin. Ne planin financiar duhet te merrni kurajën dhe te përballeni me vështirësitë qe ju kane dale.

shumë i lehtë

		7			1	5		
	9				3		2	
	1		4		8		7	
9	5	3		4		1		
		8		3		7	6	4
	7		3		6		4	
	4		8				1	
		1	5			2		

PËRKUJTIM



ENDRIT ISENI
(28.02.1997 – 28.05. 2015)

Në tre vjetorin e ndarjes nga jeta të djalit dhe vëllait tonë të dashur, e kujtojmë me mall-nëna Mijasere, babai Emrush dhe motrat Puhiza dhe Altina, nga Tetova

Mensur Mamuti	ÇITJANE FITIM, QAR	D	ELEMENT KIMIK, GAZ I PLOGET	AR (FRENGJ.)	REOMIRI	FSHAT NË PESHKOPI, FUSHE ...	HEROI (007) I AUTORIT NË FOTO (2)	MARKË KROATE PËR KOZMETIKË	KOHA	FUSHA E ENIGMAVE
ISH BASKETBOLLIST KROAT									ENERGJIA PËRMBLEDHJE E VEPRAVE LETRARE TË NJË AUTORI	
KALIFI I DYTE I ISLAMIT					AKTORI AMERIKAN, XHEK KLASA					
PREFIKS PËR PRODUKTET ORGANIKE				TË NDEJURIT NË KEMBE NË NAMAZ FLUORI						
AUTORI ANGLEZ NË FOTO (1)										
						SUEDIA		IBRAHIM MUÇAJ STUHI (SH. PASHQ.)		
						FERHAN HASANI				
						ISH NOTUESI SLOVEN, PETRIÇ				
						B				
						SUREJA E FUNDIT E KURANIT				
						DECI GRAM			KALIJUMI VRIMË OSE E ÇARË NË MUR	
						KOHA	LIDHËZ, POR, VEÇSE AUTOMOBIL			
						KËNGËTARIA OKSA				FEJA MUSLIMANE
						BITUM NATYROR (SH.)				
KOHA	ÇIFTI	ELEMENT KIMIK, GAZ PA NGJYRË	MONEDHË E IMET JAPONeze	LIDHJE QELIZASH TË NJËLLOJTA (SHQ.)	QYTET NË EGJIPT (KANALI)					
TEZË THEMELORE, RREGULL (SH.)								GALLATASARAJ		
SERIA E PARË E OVELAVE E AUTORIT NË FOTO								KAFSHË AZIATKE, E NGJASHME ME BUALLIN		
K										
QYTETI I LINDJES SE AUTORIT NË FOTO								PJESË E PARË E FJALEVE TE PREJARDHURA: SI, ASHTU SI		
								ITALIA		
ASTATI			LLOGORE (VIET)							

ZGJIDHJET: D, DINO RAXHA, E, OMER, LEMON, BIO, KIJAMI, IAN, FLEMING, S, IM, BUBA, BORUT, NASI, DG, K, AMA, ANA, SUEZI, PARIMET, GS, KAZINO ROJAL, LONDRA, ALTA, AT, ISTIKAM.

Dalin në shitje, tri shishe vere të vitit 1774

Mbajtur në një kantine që prej tetë gjeneratash, bëhet fjalë për shishe me të vjetra të verës në qarkullim. Tri shishe nga vera e verdhë e Juras, që datojnë që prej vitit 1774, do të dalin në shitje sot, në Lons-le-Saunier. Këto verëra, të tipit "burgogne", domethënë me një trup të gjerë dhe një qafë të hollë dhe me një sasi prej 87 centilitrash, përmbajnë verë të verdhë të prodhuar nga vreshtari Anatoile Vercel (1725-1786). Shisheet janë ruajtur për më shumë se 200 vjet nga pasardhësit në një hambar të mbyllur dhe me gurë, para se të tërhiqeshin dje në kuadër të shitjes në ankand. "Dalë nga një vreshtë e krijuar në kohën e Luigjit XV dhe mbledhur në kohën e Luigjit XVI, këto janë shisheet e verës më të vjetra në botë në qarkullim", konfirmoi Brigitte Fenaux, drejtuese e shtëpisë "Jura Encheres" që do të zhvillojë shitjen. Dy shishe nga i njëjti promovion ishin shitur, në vitin



2011 në Arbois për 57 000 euro dhe në 2012 në Gjenevë për 46 000 franga zvicerane (rreth 38 300 euro). "Të kesh tre shishe të atij viti dhe të asaj cilësie, është unike", theksoi Philippe Etievant, menaxher në "Jura Encheres". Një degustim i kësaj verë të

verdhë u organizua në vitin 1994 në Kështjellën Pecauld, në Arbois, nga 24 profesionistë të verës. Me ngjyrë të verdhë, me një shije arre, erëzash, kerry, kanelle, vanilje dhe frutash të thata, vera ishte vlerësuar nga testuesit 9,4 nga 10.



Shqiptari në Zvicër blen tabelat e veturës si data e lindjes, i kushtojnë mbi 1 mijë franga

Amir Kosumi që jeton në Zvicër, ka blerë tabelat e veturës ashtu siç e ka ditëlindjen, dhe i kushtuan 1770 franga. Shqiptarët janë të pasionuar pas veturave. Jo vetëm pas tyre, por edhe pjesëve, madje, edhe tabelat dëshirojnë t'i kenë të veçanta. Kështu ishte edhe dëshira e Amir Kosumit, i cili jeton në Uster të kantonit të Zürichut. "Jetoj që dhjetë vite në Zvicër dhe gjithmonë kam pas dëshirë ta kem një numër karakteristik të veturës në Zvicër, atë e kam realizuar dje, pasi në ankandin publik të tabelave për vetura e kam blerë numrin ZH 41185", ka thënë Kosumi për albinfo.ch. Këta numra janë të veçantë për të. "Numrat janë të njëjtë me datën e lindjes time, pra kam lindur më 4.11.85 (1985)", ka shtuar tutje ai. Amiri tregon sa i kushtoi dëshira e tij. "Këto tabela i kam blerë për 1770 franga zvicerane. Jam i lumtur që kam blerë këto tabela, dhe shpresoj që do t'i shfrytëzojnë edhe fëmijët e mi në të ardhmen", përfundoi Amir Kosumi.

Hekurudha e udhëhequr nga fëmijët

Një nga kodrat e blerta sipër Budapestit, një linjë hekurudhore funksionon ndërmjet stacioneve të ngulitura thellë në pyjësi. Nuk është njëri prej shërbimeve më të shpejta hekurudhore në botë, ama po që është një prej më tërheqësve. Njësoj si hekurudhat e tjera, edhe kjo ka zyrat e blerjes së biletave, lokomotivat me naftë, sinjalet, rojat dhe një orar. Por ndryshe prej të tjerave, kjo udhëhiqet ekskluzivisht prej fëmijëve. Me uniformat e tyre me ngjyrë të kuqe, të kaltër dhe të bardhë, janë të rinjtë e hekurudhës Gyermeqvasút, e cila e shënon 70-vjetorin e vet më 2018, ata që e kryejnë pjesën më të madhe të

punës këtu. Ata i shesin dhe i kontrollojnë biletat, ndërsa i përsëndesin me krenari trenat gjatë largimit të tyre prej stacioneve. E për më tepër, kjo gjë duket sikur i argëton jashtë mase. Kjo hekurudhë e vogël hungareze i rikujton skenat e një filmi të Wes Andersonit. Por në fakt është thjesht një shikim prapa kah komunizmi, periudhë kjo kur Hungaria, si një shtet satelit i Bashkimit Evropian, e krijoi hekurudhën e pionierëve për t'ua ofruar fëmijëve shansin që ta mësojnë punën ekipore dhe përgjegjësinë. Të miturit kanë punuar në këtë hekurudhë nën mbikëqyrjen e të rriturve.



Robert De Niro nuk e lejon Donald Trump të hyjë në restorantin e tij

Duke qenë udhëheqës i botës së lirë, ju do të mendoni se nuk do të ketë dyer që nuk mund të hapni, asnjë bar ku nuk mund të pini dhe asnjë restorant ku nuk mund të hani. E pra, duket sikur ky zinxhir është këputur për Presidentin e SHBA-së, Donald Trump, nga heqja e të drejtës për të frekuentuar njërin prej tyre. Restorantet Nobu janë një rrjet goxha i madh, që janë të pranishëm në të gjithë botën, që me hapjen e më të fundit prej tyre në Marbella. Ata janë në pronësi të Nobuyuki 'Nobu' Matsuhisa, Robert De Niro, Meir Teper, Dreë Nieporent dhe Richie Notta. De Niro ka zbuluar në Daily Mail se jo vetëm që Trump nuk



do të lejohet në një Nobu, por aktori i Taxi Driver tha se nuk do të hante kudo që Presidenti ishte i pranishëm. "Nuk më intereson se çfarë i pëlqen. Nëse ai hyn në një restorant ku do të isha ulur, do të dilja jashtë", tha ai për MailOnline. Kjo nuk duhet të jetë me të vërtetë një surprizë për këdo që i njeh mendimet e aktorit për Presidentin amerikan, gjë të cilën ai

sigurisht e bëri të qartë gjatë zgjedhjeve të vitit 2016. Ai lëshoi një video ku tha: "Trumpi është një copë idioti, ai është një punk, ai është një qen, ai është një derr, ai është një artist i degraduar. "Ai është një idiot, ai është një turp, ai flet për mënyrën se si ai dëshiron t'i godasi njerëzit në fytyrë, mirë, do të doja që ta godisja në fytyrë". Bobi shkoi një hap

më tej vetëm pasi u konfirmua se Trump kishte fituar zgjedhjet, duke krahasuar momentin me sulmet terroriste të 11 shtatorit. Por në qoftë se keni menduar se De Niro e mbaroi punën e tij dhe do t'i kthehej aktrimit dhe drejtimit të restorantit, jeni gabuar. Dy muaj më parë, ai foli në një event të Fulfillment Fund dhe thuhet se tha: "Përderisa udhëheqja e vendit tonë është kaq e tmerrshme dhe aq e korruptuar, do të flas për këtë në çdo vend. "Të heshtësh para fytyrës së një kafshe të tillë do të duhej të bëheshe edhe bashkëpunëtor". Pra, mund ta presim shumë të reja edhe për dy vjet e gjysmë.

1539 - Hernando de Soto zbarkon në Florida

1588 - Armata spanjolle nën udhëheqjen e Medina-Sidonia nisët nga Lisbona për të pushtuar Anglinë

1674 - Parlamenti gjerman i shpall luftë Francës

1731 - Konfiskohen të gjitha librat hebraike në shtetet papnore

1845 - Zjarri kaplon qytetin e Kuebekut dhe shkatërrohen rreth 1.500 shtëpi.

1918 - Tatarët shpallin Azerbajxhanin të pavarur.

1919 - Armenia shpall pavarësinë e saj.

1937 - Ura Golden Gate në San Francisko hapet për komunikacionin rrugor.

1964 - Jawaharlal Nehru kremohet në Nju Delhi.

1964 - Kongresi Kombëtar i Palestinës themelon Organizatën për Çlirim dhe Palestinës në Jerusalem.

1991 - Rebelët etiopas pushtojnë Adis Abebën.

1999 - Në Milano, pas 22 vjet punë restaurimi, vepra madhështore e Leonardo da Vincit "Darka e Fshehtë" sërisht vendoset në ekspozitë.

KALENDARI HISTORIK 28 MAJ



A E DINI SE...

Njeriu djegë më shumë kalori duke fjetur sesa duke shikuar televizorin.



Isak Njutni ishte 23 vjet kur zbuloi ligjin e gravitetit



Fillimisht grekët e vjetër kanë mbjellë karotat për mjekësi e jo për ushqim.



Zelanda e Re është shteti i parë në botë që ka lejuar gratë të votojnë



Kë do më shumë, mamin apo babin?
Babai : Kë do më shumë ti, mamin apo babin?
Djali : Të dy.
Babai : Jo, thuaj kë!
Djali : Të dy.
Babai : Nëse unë shkoj në Londër dhe mami në Paris, ku do të shkoje ti?
Djali : Në Paris.
Babai : Domethënë ti do mamin?
Djali : Jo, por sepse Parisi është më i bukur se Londra.
Babai : Nëse unë shkoj në Paris dhe mami në Londër, ku do të shkoje ti?
Djali : Në Londër.
Babai : Pse?
Djali : Epo Parisin e pashë me mamin...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Bëhu i sigurt që e ke vënë këmbën në vendin e duhur, pastaj qëndro i palëkundshëm.
Abraham Linkoln